

Kumbona e së Diellës



Shën Pjetri dhe Pauli nga Jusepe de Ribera ©. 1616)

KRYEDIOQEZA METROPOLITANE SHKODËR - PULT
Nr.5/6, Maj - Qershor 2024

KARD. PAROLIN: "TEKNOLOGJIA DUHET TË JETË NË SHËRBIM TË DINJITETIT NJERËZOR"

Pas audiencës me Papën, fjalimi i Sekretarit të Shtetit në sesionin përfundimtar i Konferencës Ndërkombëtare për Inteligjencën Artificiale, organizuar nga Fondacioni Centesimus Annus Pro Pontifice - R. SH. - Vatikan

Përballë sfidave të krijuara nga inteligjenca artificiale, kemi nevojë për "arsimim bazë" i cili, duke pasur parasysh përparimin teknologjik, "të synojë përmirësimin e kushteve të jetës së njerëzimit": kjo është udha për të siguruar që makinat të mbeten "të përqendruara te njeriu dhe tek mbrojtja e të drejtave të tij" dhe në këtë mënyrë "të shmangjet prirja që uniciteti i njeriut të identifikohet dhe të reduktohet në një grup të dhënash". Këtë nënvizoi Sekretari i Shtetit, Kardinali Pietro Parolin, gjatë fjalimit të mbajtur dje në Sallën Klementine - në fund të audiencës me Papën Françesku, me rastin e sesionit përfundimtar të Konferencës Ndërkombëtare për Inteligjencën Artificiale (AI) organizuar nga Fondacioni Centesimus Annus Pro Pontifice, nga data 20 deri më 22 qershor, në Institutin Papnor Patristik Augustinianum, në Romë.

Të dëgjojmë pyetjet e njeriut të sotëm

"Dëgjimi i Fjalës së Zotit - vërejtja Kardinali - kërkon të dëgjosh pyetjet dhe shqetësimet e njeriut të sotëm", përballë ndryshimeve të shpeshta që ndodhin në shoqëri. Ndërmjet tyre, me të gjitha sfidat e saj, lind tema e AI, e cila "po përhapet" në marrëdhëniet njerëzore, "duke ndikuar në zakonet individuale dhe sjelljet shoqërore", aq sa duket se po përballë, më shumë sesa "me një epokë ndryshimesh, me ndryshimin e një epoke" - theksoi Kardinali Parolin, duke cituar fjalët e Papës

Françesku. Në të vërtetë, "në krahasim me risitë teknologjike të së shkuarës, si shpikja e shtypit, motori me avull, automobili, i cili shërbeu për të transformuar botën fizike, teknologjitë e reja të informacionit përpunojnë një realitet jomaterial" dhe për këtë arsye kanë kuptim domethënës "ndikimi në mënyrën se si zhvillohet inteligjenca njerëzore".

Centesimus Annus, angazhimi i Kishës për përparimin dhe reduktimin e pabarazive Kjo çon në një "transformim strukturor të përvojës së vetvetes dhe marrëdhënieve me të tjerët", siç kishte sinjalizuar në mënyrë profetike Romano Guardini në dekadat e para të shekullit të 20-të. Është e nevojshme të merret në konsideratë, saktësoi Sekretari i Shtetit, se "Inteligjenca Artificiale është aktualisht subjekt i një baze me zhvillim të shpejtë, që shënon kalimin nga mësimi automatik" - në të cilin roli i njeriut në figurën e eksperimentuesve është themelor - për atë që quhet "të mësuarit e thellë". Në këtë të fundit, aftësia për të marrë të dhëna në mënyrë autonome mbizotëron, duke optimizuar në mënyrë progresive performancën. Prandaj është e nevojshme, theksoi kardinali, të jemi vigjilentë me kujdes që të mos i nënshtrohemi logjikës së pragmatizmit e të programimit por, përkundrazi të "drejtojmë revolucionin teknologjik në mënyrë të drejtë dhe sociale".





Imzot Angelo Massafra OFM DISHEPUJVE JEZUSI U THOTË SE E VËRTETA EKZISTON	4
Imzot Angelo Massafra OFM ARQIPESHKVI I RI KOADIUTOR	6
Imzot Giovanni Peragine NË KRISHTIN JEMI TË GJITHË VËLLEZËR TË BASHKUAR	8
Papa Françesku EMËRIM I IMZOT GIOVANNI PERAGINE!	10
Motër Marjeta Gjoka ZEMRA E KRISHTIT E BUTË DHE PËRVUAJTUR	11
Paulina Guli Hoti LA NATIONE ALBANESE	15
† Vittorio Francesco Viola O.F.M. "ZOJA E KËSHILLIT TË MIRË", NGRITET NË DINJITETIN E BAZILIKËS MINORE	17
Imzot Angelo Massafra OFM FORMIMI I BREZIT TË RI MBI VLERAT E KRISHTERA	18
Besim NDREGJONI PËRKRAHJA E SELISË SË SHENJTE NDAJ DËNIMIT TË KRIMEVE TË KOMUNIZMIT	20
Imzot Angelo Massafra OFM NJË JETË E JETUAR PËR ZOTIN E BESIMTARËT	25
Motrat Stigmatine RELIKA E GJAKUT TË SHËN FRANÇESKUT NGA VARRËT JETA E RE	26
Kronisti MËSHIRËS SATE O ZOTI IM, NË AMSHIM DO T'I KËNDOJ	29
Kronisti P.CAMILLO LIBARDI	30
Kronisti AMARCORD	31
Redaksia VITRINA E LIBRIT	32

KUMBONA E SË DIELLËS

Viti XXXVII, nr. 5/6 (579 - 580) Maj - Qershor 2024

Revistë Fetaro-Kulturore

Drejtues

Imzot Angelo MASSAFRA

Redaksia:

Dom Nikë Ukgjini (Kryeredaktor)

Dom Vlash Palaj

Dom Gjovalin Simoni

Xhon Nika (Redaktor Teknik)

Adresa:

Arqipeshkvia Shkodër

Sheshi Gjon Pali II

Tel. 0222-42764 / Fax. 0222-43673

e-mail: n_ukgjini@yahoo.it

www.kishakatolikeshkoder.com

KRYEDIOQEZA METROPOLITANE SHKODËR - PULT



DISHEPUJVE JEZUSI U THOTË SE E VËRTETA EKZISTON!

Homela e Imzot Angelo Massafra Rrëshajët

Shkodër, 19/05/2024

Festa e Rrëshajëve përfundon dhe përmbush misterin e Pashkëve: Shpirti i Shenjtë, tashmë i derdhur në zemrat e të pagëzuarve, vepron sot, në kohën e tanishme, në secilin prej nesh, atë që Krishti ka realizuar në vdekjen dhe ringjalljen e tij, domethënë njeriun e ri të shëlbuar nga mëkati dhe vdekja e përjetshme, por edhe jetën e re në këtë tokë dhe që do të vazhdojë në përjetësi në bashkësinë intime dhe të thellë me Trininë e Shenjtë.

Koha e inauguruar nga zbritja e Shpirtit Shenjtë mbi Apostuj, të mbledhur me Marinë në Qenakull (siç dëgjuam në leximin e parë) është, pra, koha e Kishës; domethënë koha në të cilën të gjithë të pagëzuarit jetojnë “*nëpër Krishtin e me Krishtin dhe*

tuaj ndaj Tij. Për këtë arsye ju duhet të mbani mend gjithmonë se jeni Kisha e sotme; jo individë që e jetojnë besimin e tyre në mënyrë individualiste, por bashkësi njerëzish të bashkuar me Krishtin.

Në këtë vit liturgjik, Ungjilli, i cili është i ndryshëm nga ai i viteve të tjera liturgjike, thërret vëmendjen tonë për një veprim të veçantë të Shpirtit Shenjtë në jetën e të pagëzuarve: njohja e së vërtetës.

Ta pyesim veten: nga se përbëhet e vërteta? Jezusi flet për këtë me dishepujt e tij në kontekstin e Darkës së Fundit dhe tema do të kthehet në gjyqin para Ponc Pilatit. Dishepujve Jezusi u thotë se e vërteta ekziston, por tek ajo arrihet gradualisht (“*Tani s’mund të kuptoni*”), por ai e siguron dhuratën



në Krishtin”, kështu siç thotë krenmtuesi në fund të lutjes eukaristike. Kisha, në fakt, nuk është një strukturë fizike, as një strukturë shoqërore ose juridike, por bashkësia e atyre që kanë besuar në Krishtin dhe janë pagëzuar në vdekjen dhe ringjalljen e tij; pikërisht ashtu siç na mëson Shën Pali në Letrën drejtuar Romakëve, kapitulli 6, vargjet 3-4.

Dhe ju, shumë të dashur, kandidatë për Sakramentin e Krezmimit, duhet të jeni të vetëdijshëm që jeni Kisha e sotme: njerëz që, me Pagëzimin, jeni bashkuar me Krishtin dhe tani, me Sakramentin e krezmimit ju konfirmoni përkatësin

e Shpirtit që “*do t’ju udhëzojë ta njihni tërë të Vërtetën*”. Ndërsa Pilatit, nuk do t’i japë asnjë përgjigje dhe ne e kuptojmë pse: nëse dishepujt që jetuan me të nuk janë ende në gjendje të kuptojnë të vërtetën, si mund ta kuptonte një pagan?

Nga i gjithë Ungjilli i Gjonit dhe më pas edhe nga Letrat e tij kuptojmë se e vërteta qëndron në besimin se Jezusi është Biri i Hyjit dhe se në emrin e tij ne mund ta marrim shpëtimin. Megjithatë, të njohim këtë nuk mjafton: ka një rritje në të vërtetën që vetëm Shpirti Shenjtë mund të lejojë. Në fakt, askush nga ne nuk mund të thotë se e njohim plotësisht misterin e Krishtit dhe çfarë ndikimi ka në



jetën tonë të kuptuarit e këtij misteri. Prandaj, çdo ditë është një mundësi e re për të hyrë në një marrëdhënie me Krishtin për tu "rritur në njohjen e Tij" - si na nxisin të bëjmë, apostujt Pjetri (2Pt 1,5) dhe Pali (Efes. 4, 15-16) të veprojnë.

Nuk mjafton të kesh qenë në katekizëm si fëmijë: duhet një pjesëmarrje e ngushtë (sa prej nesh qëndrojnë me dëshirë përpara Eukaristisë?); duhet një lutje që të jetë dialog i thellë dhe i sinqertë, heshtje dhe soditje (sa prej nesh duan të rrinë në lutje për pak kohë por çdo ditë?); padyshim që të gjitha këto gjëra duhet të bashkohen me formimin e krishterë e cila nuk ndalet në moshën e katekizmit (sa prej nesh kërkojnë mundësi për katekizëm dhe formim të krishterë?). Në të gjitha këto gjëra vepron Shpirti i Shenjtë: vetëm në këtë mënyrë mund të arrijmë këtë lloj njohjeje.

Prandaj, të dashur kandidatë për krezmim, ju bëj thirrje që të mos ndërprisni rrugëtimin tuaj të formimit por ta vazhdoni duke pranuar të gjitha propozimet që ju ofron komuniteti i krishterë.

Dhe dija shkon dorë për dore me dashurinë: sa më shumë ta njohim Krishtin, aq më shumë e duam atë. Dhe çfarë tjetër është kjo dashuri nëse jo Shpirti i Shenjtë? Ne e përcaktojmë Shpirtin si Dashurinë që është ndërmjet Atit dhe Birit; por Hyji nuk është xheloz për dashurinë e tij; ai ua jep të gjithëve me bollëk. Pra, si thotë gjithmonë Shën Gjoni në letrat e tij, nëse jetojmë me këtë dashuri, hyjmë edhe ne në të njëjtën marrëdhënie që ekziston midis tre Personave hyjnorë: Ati, Birit dhe Shpirti i Shenjtë. Le të mendojmë: Sa dhuratë të madhe na jep Zoti duke na



lejuar të hyjmë në këtë intimitet me Të!

Dhe së fundi, Ungjilli i sotëm na zbuloi aspektin tjetër të rëndësishëm: dëshminë. A mundet një zemër që rritet në njohurinë dhe dashurinë e Krishtit të mos japë dëshmi të mirë për Krishtin? Jezusi na flet për një dëshmi të dyfishtë: **1.** Shpirti i Shenjtë dëshmon në favor të Krishtit në zemrën e besimtarëve, duke e mbrojtur atë nga mosbesimi i botës; **2.** Besimtarët, kështu të forcuar nga vepra e Shpirtit, mund të dëshmojnë për Krishtin përpara botës.

Me të drejtë thuhet se me sakramentin e Krezmimit bëhemi ushtar të Krishtit, por në çfarë kuptimi? Pikërisht për guximin për ta dëshmuar Atë para botës. Simboli i shuplakës së vogël që do të merrni nga ipeshkvi nënkupton pikërisht këtë guxim dëshmie.

Vëllezër dhe motra, e gjithë kjo është zemra e jetës së një të pagëzuarit! Sot më shumë se kurrë, përballë mosbesimit të botës, ata që ndihen vërtet të krishterë nuk mund të shmangin rritjen e njohjes së Krishtit. Është urgjente t'i japim një dëshmi të mirë! Por për ta bërë këtë duhet të jetojmë jetën e Shpirtit dhe të shijojmë praninë e tij dhe frytet e tij, sipas listës që Shën Pali bëri në leximin e dytë që dëgjuam (lexojini).

Këto janë virtytet që i bëjnë kontrast veprat e mishit (lexojini).

Para shpalljes së Ungjillit, u këndua himni i lashtë latin i Venit, Sancte Spiritus;

tani po e përsëris në shqip: Ju ftoj të bashkoheni me mua në këtë thirrje që duhet ta përsërisim çdo ditë (lexojeni).

Uroj secilit prej jush që çdo ditë e jetës suaj të jetë një Rrëshajë e re: përmbushja e përsosur e Pashkëve të Krishtit në mënyrë që bota të besojë dhe të shpëtohet.

Hyjit Atë i qoftë lavdi, e Birit që u ringjall prej së vdekurish dhe Shpirtit Shenjtë, në shekujt të shekujve. Amen.





PREZENTIM I ARQIPESHKVIT TË RI KOADIUTOR
Shkodër, në katedrale, 20/05/2024

Në Katedralen e Shën Shtjefnit në Shkodër, me datë 20 Maj, 2024, në praninë e klerit të dioqezës, meshtarëve, rregulltarëve, besimtarëve, e mediuemeve, u bë publikimi i emrit të pasardhësit të arqipeshkvit të Arqidioqezës së Shkodër- Pult të Imzot Angelo Massafres. ipeshkëvi i deritanishëm i Shqipërisë së Jugut, Sh. Tij Giovanni Peragine.

Sh. Tij Giovanni Peragine do të jetë Arqipeshkvi (Koadiutor) i Arqidioqezës Metropolitane Shkodër-Pult i emëruar nga Ati i Shenjtë, Papa Françesku.

Nga fjala e Mons. Massafres:

Të dashur vëllezër e motra,

Ju falënderoj që i jeni përgjigjur ftesës së Kancelarit, Atë Artan Seli, për të qenë këtu sot për të marrë këtë komunikim të rëndësishëm që, tashmë prej kohësh po e prisnim e, sigurisht, do të keni kuptuar për çfarë bëhet fjalë.

Po, ka ardhur më në fund nga Selia e Shenjtë ky komunikim:



NUNZIATURA APOSTOLICA
IN ALBANIA

Tiranë, 13 më Maj 2024

Nr. 581/24

Shkëlqesi,

Kam kënaqësinë të njoftoj Shkëlqesinë Tuaj së Ati i Shenjte, Françesku, ka pranuar kërkesën tuaj, për emërimin e një Arqipeshkvi Koadiutor për Arqipeshkvinë Shkodër –Pult dhe ka emëruar në këtë detyre, Sh. T. Imzot Giovanni Peragine, deri tani Administrator Apostolik i Shqipërisë së Jugut.

Në marrëveshje më Shkëlqesinë Tuaj dhe Sh. T. Imzot Peragine, shpallja e këtij emërimi do të bëhet ditën e hënë më 20 maj, Përkujtim i së Lumes Virgjër Mari, Nëna e Kishës.

Ndërsa Ju njoftoj këtë vendim të Papa Françeskut, ju shpreh Juve Shkëlqesi, dhe Koadiutorit Tuaj urime të përzemërta, vëllazërore për bashkësi dhe bashkëpunim të thellë për të përgatitur mirë, - kur do të gjykohet e përshtatshme – zëvendësimin tuaj.

Përfitoj me kënaqësi nga rastin për t' ju përsëndetur vëllazërisht në Zotin

Shkëlqesisë së tij Fort të Nderuar
Imzot Angelo Massafra O.F.M.
Arqipeshkvi Metropolit i Shkodër- Pult

+ Luigi Bonazzi
Nunci Apostolik

SHKODËR



E falënderoj Atin e Shenjtë që ka pranuar kërkesën time për të pasur një Ispeshkëv Koadiutor për Arqidioqezën tonë e që ka zgjedhur Imzot Giovanni Peragine për këtë qëllim.

Pak ditë më parë, në leximin e dytë të Shërbesës së Leximeve kemi lexuar një tekst nga Kushtetuta Dogmatike mbi Kishën, të Koncilit të dytë të Vatikanit në të cilin thuhej:

Mbarë Kisha paraqitet porsë “populli i tubuar në bashkim me Atin, Birin dhe Shpirtin Shenjt”.

Të dashur, me të drejtë mund të besojmë se kjo zgjedhje e Selisë Shenjtë, edhe duke marrë para sysh faktin që është dashur më shumë se një vit, të jetë përmbushur me kujdes e me besim në Shpirtin Shenjt i cili ka folur edhe me gojë të atyre që kanë qenë konsultuar për këtë qëllim.

Prandaj ju ftoj të bashkoheni me mua për të falënderuar Hyjin që, me Shpirtin e tij, vazhdon ta udhëheqë Kishën e tij që të jetë, e bashkuar Hierarki e laikë, prani e gjallë e Krishtit në këtë botë.

E pas Hyjit, falënderimi ynë i shkon Virgjërës Mari që sot e kujtojmë si Nënë të Kishës: prania e saj në Çenakull e bashkuar në lutje me Kolegjin Apostolik nuk ka mbaruar, por vazhdon të bëjë të ndihen efektet e saj shpirtërore edhe sot.

Dhe në fund, por jo krejt e fundit, një falënderim të sinqertë Imzot Giovanni i cili ka pranuar me dashamirësi ftesën e Atit të Shenjtë për të ofruar shërbimin e tij apostolik në këtë Kishën e dashur Shkodër-Pult.

Shumë prej nesh e njohin tashmë Imzot Peragine e kanë patur mundësi të vlerësojnë cilësitë e tij njerëzore, shpirtërore e udhëheqëse. Megjithatë, më duket e drejtë të shoqëroj këtë lajmërim edhe me një profil të shkurtër biografik në mënyrë që të gjithë të çmojnë e të pranojnë Ispeshkvin e ri Koadiutor.

Jetëshkrimi i ipeshkvit të ri:

Shkëlqesia e tij Imzot Giovanni Peragine Barnabit, është 59 vjeç dhe ka lindur në Itali (Bari).

Ka hyrë në “Shkollën Apostolike” të Etërve Barnabitë në vitin 1976.

Ka frekuentuar studimet filozofike e teologjike në Universitetin Urbaniana në Romë, duke i përfunduar ato me Liçencën në Teologji biblike. Më 17 nëntor 1991 ka bërë kushtet e përjetshme në Romë në Kongregatën e Klerikëve të Rregullit të Shën Palit e më 20 mars 1993 ka qenë shuguruar meshtar.

Pas shugurimit meshtarak ka zhvilluar detyrat që vijnë: Ndihmës Famullitar e Përgjegjës i aktiviteteve rinore në Famullinë “Nëna e Provanisë Hyjnore” në Firencë, Mësues i Religjionit në Kolegjin “Alle Querce” të Etërve Barnabitë.

Në vitin 1998 ka qenë dërguar si misionar në Shqipëri, ku ka zhvilluar apostolatën e tij në famullinë e “Shën Nikollës” në Milot e si Përgjegjës i formimit në Seminarin lokal të Etërve Barnabitë. Nga viti 2002 ka qenë Famullitar i të njëjtës famulli e Dekan i zonës veriore të Arqidioqezës Tiranë-Durrës.

Nga viti 2006 ka qenë Konsultor i Këshillit Provincial të Etërve Barnabitë të Provincës qendër-jug të Italisë.

Nga viti 2008 deri në vitin 2017 ka qenë President i Konferencës Shqiptare të Eprorëve të Lartë.

Nga viti 2009 deri në vitin 2012 ka qenë Vikar Provincial i Provincës qendër-jug të Etërve Barnabitë.

Nga viti 2009 deri në 2018 ka qenë President i Bashkimit të Konferencave Europiane të Eprorëve të Lartë.

Më 15 qershor 2017 ka qenë emëruar Administrator Apostolik i Shqipërisë së jugut dhe është shuguruar ipeshkëv më 7 shtator 2017.

Shkëlqesia e tij Imzot Peragine aktualisht është Sekretar gjeneral i Konferencës Ipeshkvore të Shqipërisë.

Të dashur vëllezër e motra jam i kënaqur të shoh të siguarur të ardhmen e Arqidioqezës që ia besoj kujdesit amnor të Nënës së Hyjit e Nënës sonë, shenjtës sonë Tereza e Kalkutës, si edhe ndërmjetësimit të të Lumëve tanë Martirë që, të cilët me dashurinë e tyre për Kishën, sigurisht që luten për ne.

Ju falënderoj edhe një herë të gjithë juve që keni pranuar ftesën për të qenë këtu të pranishëm sot dhe ju kërkoj që të luteni për këtë Kishën tonë lokale, për Ispeshkvin e ri Koadiutor e për mua.

**Arqipeshkvi i Shkodër – Pult
Imzot Angelo Massafra**



NË KRISHTIN JEMI TË GJITHË VËLLEZËR TË BASHKUAR

Omelia e Imzot Giovanni Peragine, Shkodër më 09.06 .2024

Me dt. 9. Qershor 2024, Mons. Giovanni Peragine bëri hyrjen solemne dhe kremtoi meshën e parë si Arqipeshkëv kuadiutore i Arqidioqezës Shkodër-Pult.

Në prezantimin e ipeshkëvit të rij kuaditor, në meshën ora 10 në Katedrale, morën pjesë: ipeshkvi i Lezhës, Ottavio Vitale; ipeshkvi i Sapës, Simon Kulli; Nunci Apostolik në Tiranë, Luigi Bonazzi dhe ipeshkvi ordinar vendas Angelo

Gjatë kësaj meshë u lexua Bulla zyrtare e papa Françeskut të dt. 20 maj 2024, për emërimin e Imzot Giovanni Peragine, për ipeshkëv kuadiutorë të Arqipeshkëvisë të Shkodër-Pult.

Të dashur vëllezër dhe motra

" Kush është nëna ime dhe kush janë vëllezërit e mi?"

Kjo është pyetja që Jezusi u bën atyre që i thanë se nëna e tij dhe vëllezërit e tij ishin jashtë duke e kërkuar.

Është vetë Jezusi, i cili, duke e zgjeruar vështrimin drejt të gjithë atyre që i kishte përreth dhe ishin duke e dëgjuar, çuditërisht i jep përgjigje pyetjes : "Kushdo që bën vullnetin e Zotit është vëllai, motra dhe nëna ime".

Të dashur vëllezër dhe motra, përpara se të vazhdoj me meditimin e pjesës së Ungjillit që kemi dëgjuar, para se gjithash, në këtë kremtim eukaristik, gjatë të cilit zyrtarisht filloj shërbimin tim si Arqipeshkëv koadiutor i kësaj Arqidoqeze Shkodër-Pult, dëshiroj të rinovoj besimin tim në Zotin, i cili vazhdon të më kërkojë të vendos veten në duart e tij dhe të bëj vullnetin e tij. Ai më kërkon edhe një herë që të lë gjithçka dhe ta ndjek, edhe një herë më thotë "Eja dhe më ndiq mua".

Në personin e Nuncit Apostolik Mons. Luigi Bonazzi, dua të falënderoj Atin e Shenjtë, Papa Françeskun, i cili më ka dashur si Arqipeshkëv koadiutor të kësaj Arqidoqeze të bukur dhe të madhe që unë tashmë e dua dhe që dalëngadalë do të filloj ta njoh për të vlerësuar edhe më shumë pasuritë e saj.

Falënderoj Imzot Angelo Massafra që më mirëpriti ashtu siç një Atë mirëpret djalin e vet të cilit po përgatitet t'i dorëzojë një thesar të ruajtur dhe të kultivuar për shumë vite. Që tani e falënderoj Mons. Angelo për shërbimin baritor të tij të gjatë, i cili ende nuk ka përfunduar, në këtë Arqidoqezë. Së bashku me ipeshkëvinjtë e dy dioqezave sufragane, Imzot Simon Kulli dhe Imzot. Ottavio Vitale, përshëndes të gjithë priftërinjtë, edhe ata që nuk janë të pranishëm, përshëndes rregulltarët dhe rregulltarët dhe përshëndes përzemërsisht të gjithë ju besimtarët që jeni pasuria e vërtetë e kësaj dioqeze. Faleminderit për mirëseardhjen tuaj të bukur e të ngrohtë, të cilën do të përqipem t'ua kthej me kujdesin dhe afërsinë ndaj të gjithëve.

Po, është e vërtetë, Zoti na kërkon të bëjmë gjithmonë vullnetin e tij dhe jo tonin. Ai na kërkon të bëjmë atë që ai dëshiron dhe jo atë që na pëlqen, në mënyrë që të bëhemi



familjarët e tij, domethënë që të mund të marrim pjesë në gëzimin e tij, në jetën e tij.

Ungjilli i sotëm i kërkon secilit prej nesh të shqyrtojë se cila është marrëdhënia jonë me Zotin?

A ndihemi në të vërtetë pjesë e familjes së Zotit, a ndihemi vërtetë fëmijë të Zotit dhe si e jetojmë këtë bijësi?

A na ndihmon Fjala e Zotit që dëgjojmë të rritemi në këtë marrëdhënie dashurie me Atin?

Ungjilli na paraqet tre reagime të ndryshme ndaj predikimit të Jezusit.

Reagimi i parë është ai i të afërmeve të Jezusit, familjarëve të tij më të afërt, të afërmeve të gjakut, të cilët, duke dëgjuar atë që Jezusi thoshte, përpiqen të shkojnë dhe ta marrin sepse mendojnë se ai tani "nuk është në vete". Jemi në fillim të shërbimit publik të Jezusit dhe e kuptojnë menjëherë se mësimi i tij nuk është si ai i skribëve dhe farisenjve. Jezusi dallohet menjëherë nga të tjerët sepse nuk përsërit atë që thoshin të gjithë mësuesit, por mësonte një mesazh të ri që kundërshtojte me zakonet e lashta të etërve dhe që shpall një marrëdhënie me Zotin që lind nga kthimi i zemrës dhe jo nga zbatimi i jashtëm i urdhërimeve. Kjo sjellje publike e Jezusit, e cila u konsiderua si skandal, nuk mund të pranohej nga familja e tij, e shqetësuar vetëm për të mbrojtur nderin dhe reputacionin e tij të mirë. Pra, ishte më mirë të deklarohesh një sëmundje mendore e Jezusit sesa të përhapej turpi për familjen.



Le të mendojmë për të gjitha rastet që nderimi i familjes dhe zbatimi i traditave, shpesh larg nga një logjike ungjillore, konsiderohen nga ne si ligji i parë që duhet të zbatohet, duke e zvogëluar marrëdhënien tonë me Zotin vetëm në praktika të jashtme dhe jo nga dëshira për t'u ripërtërirë nga Fjala e tij.

Reagimi i dytë është ai i skribëve që kishin zbritur nga Jerusalemi të cilët thanë se Jezusi ishte i pushtuar nga djalli në veprimet e tij. Jezusi e përkufizon këtë mëkat si të pafalshëm pasi nuk ka të bëjë vetëm me mospranimin e veprimeve të Jezusit, por të konsideje vetë Jezusit të sunduar prej djallit, që ai nuk vepron me fuqinë e Shpirti Shenjtë.

Sigurisht, asnjë prej nesh nuk mund të deklarojë hapur se Jezusi punon nën veprimin e djallit, por kur nuk kryejmë veprat e Shpirtit të Shenjtë që është në ne, edhe ne fyejmë Shpirtin e Shenjtë. Dhe Shën Pali na paraqet qartë veprave që janë në kundërshtim me Shpirtin: mosmarrëveshjet, xhelozia, përçarjet, zilia. Kur bëjmë këto vepra, ne fyejmë Shpirtin e Shenjtë që është në ne. Mosmarrëveshjet në familjet tona, përçarjet në Kishën tonë, zilia në bashkësitë tona famullitare, midis grupeve të ndryshme, përçarjet midis të krishterëve janë një mëkat kundër veprimit të Shpirtit të Shenjtë. Kur nuk jam në bashkim me vëllain tim, kur e kam zili tjetrin ose nuk e fal, kur tjetrin e trajtoj vetëm për interesin tim, nuk lejoj hirin e Zotit dhe veprimin e Shpirtit të Shenjtë që të veprojë brenda meje.

Reagimi i tretë është ai i atyre që mirëpresin Jezusin dhe Fjalën e tij dhe e vënë veten në shërbim të tij duke u bërë pjesë e familjes së tij. "Kushdo që bën vullnetin e Zotit është vëlla, motër dhe nënë." Me këtë përgjigje, Jezusi deklaroi se për të qenë familjaret të Zotit, nuk mjaftojnë lidhjet njerëzore dhe madje edhe lidhjet

e gjakut. Nëse për t'u ndjerë i lidhur me një familje njerëzore është e nevojshme të kesh të njëjtin gjak, për të qenë pjesë e familjes së Zotit është e nevojshme të përmbushësh vullnetin e tij, domethënë të mishërosh Fjalën e tij dhe të jetosh siç jetoi Jezusi. Në një rast tjetër Jezusi do të përsërisë të njëjtën gjë: *Jo ata që thonë vetëm me fjalët o Zot! O Zot! është një i krishterë i mirë, është dishëpulli im, por ai që zbaton konkretisht vullnetin e Zotit.*

Nëpërmjet pagëzimit të gjithë jemi futur në jetën e Krishtit dhe në Krishtin jemi të gjithë vëllezër të bashkuar nga gjaku i Krishtit i derdhur në kryq për dashurinë. Dhe me Shën Palin mund të themi se mes

nesh "nuk ka më hebre dhe grek; nuk ka më as shqiptar as italian, nuk ka më skllav e as të lirë; nuk ka më burrë e grua, sepse të gjithë jeni një në Krishtin Jezus."

Vëllezër, është shumë e vërtetë: në Krishtin jemi të gjithë vëllezër, sepse që ti përkasim Krishtin nuk është çështje gjaku, por është çështje zemre, sepse gjaku pa zemër nuk jep jetë.

Të dashur, duke ardhur mes jush si bari i kësaj Kise, po vij si vëlla. Si i krishterë ndihem vërtet vëllai juaj, ndihem bir i Kishës dhe gjithashtu bir i kësaj toke. Erdha në Shqipëri si misionar 26 vjet më parë dhe me gjithë dobësitë e mia u përpoqa t'i shërbej kësaj kise fillimisht si misionar në Milot dhe më pas si misionar në Jugu e Shqipërisë. Gjaku im nuk është shqiptar por ju siguroj se zemra ime është origjinale shqiptare, sepse unë e dua këtë Kishë, unë e dua këtë tokë të larë nga gjaku i shumë martirëve dhe nëpërmjet shërbimit tim këtu dua të vazhdoj të zbatoj vullnetin e Zotit çdo ditë dhe të rritem në bashkësi me të gjithë ju.

Zojës së Këshillit të Mirë dhe të Lumëve martirë Shqiptarë ju besoj të gjithëve ju dhe shërbesën time mes jush.

+ *Imzot Giovanni Peragine*





EMËRIM MË TË DREJTËN E TRASHËGIMISË TË SELISË, SHKODËR –PULT, TË IMZOT GIOVANNI PERAGINE

BULLË

Romë, 20 maj 2024.

Françesku ipeshkëv, shërbëtor i shërbëtorëve të hyjit, vëllait të nderuar Giovanni Peragine, Barnabit, i emëruar deri tani Ipeshkëv me titullin Feniks dhe Administrator Apostolik i Shqipërisë së Jugut, Arqipeshkëv Koadiutor i Shkodër-Pult, shëndet e bekim.

Ndërsa zhvillon jetën e vet të shumanshme dhe veprimtaritë e saj të shumta, krejt Kisha merr nga Virgjëra Nëna e Hyjit shembullin e imitimit të përsosur të Krishtit, mbështetur nga ai shkëmbim i mrekullueshëm dhe nga lidhjet më të ngushta që ekzistojnë midis tij dhe gjininë njerëzore (shih Shën Pali VI, Fjalimi në përfundim të seancës së tretë të Koncilit II të Vatikanit).

Sa më shumë që të përtërihemi te burimi i hirit hyjnor, aq më shumë i dobishëm për ne, që në fe jemi ngarkuar me detyrën për t'u kujdesuar për krejt grigjën e Zotit, që të vëmë në Zotin gjithçka që



është e nevojshme për të garantuar përparimin e Kishës, që ta drejtojmë shpirtin me dashuri atërore kah nevojat shpirtërore të grigjës së dashur Shkodër-Pultit të Shqipërisë, për të cilën Bariu, Vëllai i nderuar Angelo Massafra O.F.M., kërkoi ndihmë në kryerjen e detyrës në arqidioqezën e tij, për të favorizuar një përparimin më të frytshëm shpirtëror të popullit të Hyjit.

Këtë detyrë, Bir i dashur, deshëm të ta besojmë ty, që të gjetëm të pajisur me dhuratën e mendjes dhe të zemrës, që të bën të përshtatshëm për ta kryer këtë vepër ipeshkvnore.

Prandaj, me këshillën e Sekretariatit të Shtetit dhe të Dikasterit për Ipeshkvijtë, me plotësinë e autoritetit Tonë Apostolik, të lirojmë nga lidhja e titullarit superior të Kishës dhe nga detyra e Administratorit Apostolik dhe të emërojmë Arqipeshkëv Koadiutor të Shkodër-Pult, me të drejtat dhe detyrimet përkatëse.

Dëshirojmë që ta njoftosh për këtë dekret klerin dhe popullin e kësaj bashkësie kishtare, të cilëve u bëjmë thirrje që të të kenë atë, mësues dhe rojtar.

Ati i mëshirës, o Vëlla i nderuar, bëftë që kjo grigjë, për ndërmjetësim të Zojës së Këshillit të Mirë e shembullit të veprave të tua baritore, dhe mbarë Kisha të jetë dita-ditës gjithnjë e më e frytshme, të gëzohet për shenjtërinë e bijve të saj dhe të tërheqë në kraharorin e saj njerëz vullnetmirë, në të cilët Hyji, Ati i mëshirës, të mbushtë me urti, dije e gëzim (krh. Kish 2,26).

Dhënë në Romë, në Lateran, në ditën e njëzetë të muajit maj, në vitin e Zotit dy mijë e njëzet e katër, në të dymbëdhjetën e Pontifikatit tonë.

Papa Françesku





Moter Marjeta Gjoka

Punëtore e Vogël e Zemrave të Shenjta

ZEMRA E KRISHTIT E BUTË DHE PËRVUAJTUR

« *Kini në ju po ato ndjenja që ishin në Krishtin Jezus* » (Fil 2, 5).

Një zgjedhë e butë

« Merrni mbi vete zgjedhën time e pranoni t'ju mësoj unë që jam zemërbutë e i përvuajtur. Kështu do të gjeni pushim për shpirtrat tuaj, sepse, vërtet, zgjedha ime është e ëmbël e barra ime e lehtë » (Mt 11, 29-30). I përvuajtur ndaj Atit, Jezusi e zbulon veten me mënyrën se si ju drejtohet njerëzve, ju drejtohet atyre me një thjeshtësi aq të madhe, duket qartë se sa i përvuajtur është. Sjellja e tij tregon se Ai i përmbahet doktrinës së vet. Megjithatë, ai mban brenda vetes shumë arsye të tjera sepse është në fakt i dërguari nga Ati edhe pse shpesh herë do të përballet me ata që e kundër-shtojnë në besim, për shkak të atij që e dërgoj. Ai është Drita, e Vërteta dhe kërkon nga të gjithë ata që e duan të vërtetën ta dëgjojnë zërin e tij. Si thotë Pjetri, « Te kush të shkojmë, Zotëri? Ti ke fjalët e jetës së pasosur! Ne besojmë dhe e dimë se ti je Shenjti i Hyjtit! » (Gjn 6, 68-69). Kuptohet se Ai zotëron fjalët e jetës së përjetshme, Ai e garanton doktrinën e tij me mrekulli dhe çdo njeri i prirur duhet të pranojë, sipas shprehjes së Nikodemit, se askush nuk mund të bënte mrekulli kaq të mëdha nëse Zoti nuk do të ishte me të. E megjithatë, kur ai dëshiron të tërheqë njerëzit tek vetja dhe t'i bindë ata që ta ndjekin atë, ai preferon t'u paraqesë atyre butësinë dhe përvujtërinë e zemrës së tij si arsye themelore. Apeli më i thellë dhe më efektiv fillon nga dashuria e tij.


Jezusi për faktin që na paraqitet me përvuajturin e tij nuk do të thotë që ka hequr dorë nga të qënurit Biri i Hyjtit, përkundrazi na tregon se cila është logjika hyjnore. Me praninë e tij, me sjelljen e tij ndaj njerëzve ai dëshiron të tregojë dashamirësin e tij themelore.

Ndërsa mësuesit e ligjit u jepnin të tjerëve këshilla që ishin të pamundura dhe sipas tyre këta këshilla kishin aftësinë t'i shpëtojnë, ndërsa farisenjtë mbytnin ndërgjegjen me ashpërsinë e tyre fyese, Jezusi dëshiron të shmangë çdo dominim tiranik, dhe ka kujdes dhe është plot vëmendje për njerëzit, përpiqet të ju lehtësojë ligjin që ju jep. Ai nuk ndjehet Zot Suprem, nuk ka egoizmin dhe



krenarinë e një autoriteti që lartësohet duke nënshtruar të tjerët. Ai e vendos veten në mënyrë të përsosur në nivelin e atyre me të cilët është i destinuar të mbretërojë. Nuk ka për qëllim për t'u bërë përshtypje të tjerëve, ai nuk beson se duhet të sillet si një zotëri i madh dhe as të mbajë distancë. Ai as nuk tregon shkencën e tij. Shqetësimi i tij i vetëm është të ndihmojë njerëzimin.

I butë dhe i përvuajtur, është karakteristik bashkimi i butësisë me përvuajturin. Ka lloje të përvujtërisë që bëhen të bezdisshme në vend që të jenë joshëse, ka shpirtra që kënaqen duke përbuzur veten dhe duke e konsideruar veten si asgjë, ata tërhiqen në vetvete me besimin e kësaj asgjëje. Ata kërkojnë më shumë të dëshpërojnë veten sesa të promovojnë të mirën e të tjerëve, me mënyrën e tyre



të turpshme dhe të sekletshme të sjelljes, të fiksuar në mënyrë efikase me egon e tyre, ju mungon entuziazmi dhe sinqeriteti. Kjo pamje melankolike dhe madje pak e prekur nga përvujtëria nuk ka të bëjë fare me figurën e Shpëtimtarit. Përvujtëria e Jezusit është zemërbutësia, është e drejtuar ndaj të tjerëve, ndaj të cilëve ai sillet me mirësi. Përvujtëria e Jezusit konsiston në dhurimin e tij ndaj të tjerëve. Në vend që të mbyllet në vetvete ai hapet krejtësisht ndaj të tjerëve, gati saqë harron vetveten. Ai bëhet ngushëllim për të gjithë, dëshiron të vë në dukje jo vetveten por të tjerët, kjo është përvujtëria e zemrës së Jezusit.

Përvujtëria e Jezusit në jetën e tij, si në fshehtësi poashtu në jetën publike

Tridhjetë vitet e kaluara në Nazaret janë prova e qartë e kësaj përvujtërie. Jezusi si fëmijë dhe i ri nuk përpiqet të dallohet apo të përfitojë nga dhuratat e tij të jashtëzakonshme. Ai di ta mbajë veten të fshehur në mënyrën më të natyrshme, e cila frymëzohet nga dashuria e vërtetë dhe dëshira autentike për të dëshiruar të mirën e të tjerëve, dhe jo të tijën. Bashkëvendësit e tij nuk i kushtojnë vëmendje dhe e konsiderojnë një person si të gjithë të tjerët, pa ndonjë rëndësi të veçantë. Ata nuk e kuptojnë atë që vetëm sytë depërtues të Marisë mund të shohin, domethënë që Jezusi mbetet vullnetarisht në hije. Në këtë mënyrë ai arrin të kalojë si një njeri absolutisht i ngjashëm me të tjerët, i humbur mes të tjerëve. Por vëmendja e Virgjëres Mari tërhiqet në një mënyrë të veçantë nga karakteri vullnetar i bindjes së saj, në kohën e pelegrinazhit në tempullin e Jeruzalemit, Jezusi kishte treguar se zotëronte një fuqi më të lartë

se prindërit e tij, nëse ai këmbëngul në nënshtrimin e tij, kjo është për shkak se ai e dëshiron atë. Përkundrazi, fqinjët janë mjaft të pirur të shohin në këtë nënshtrim, i cili vazhdon edhe pas moshës njëzet vjeçare dhe është kaq i përsosur, shenjën e një karakteri të qetë, pa njëfarë energjie. Ky fakt e ndihmon Jezusin të arrijë qëllimin e tij, të fshihet nga sytë e botës.

Kur në moshën dymbëdhjetë vjeç ai qëndron në tempull, ai shfaq një formë tjetër përvujtërie. A nuk është ai në shtëpinë e kushtuar Zotit? Dhe a nuk është ai vetë Zot i atij ligji që mësuesit dhe dijetarët e ligjit duan të shpjegojnë? Ungjijtë apokrifë imagjinojnë se fëmija e vendos veten mes mësuesve për t'u dhënë atyre mësimet e tij. Por historia e Lukës sugjeron një qëndrim shumë të ndryshëm, Jezusi sillet si një nxënës, ai dëgjonte fjalët e dijetarëve dhe u bën atyre pyetje, (krh. Lk 2, 42-46). Ka të ngjarë, që ai fillimisht të jetë bashkuar me një grup nxënësish dhe është vënë re nga ndonjë dijetarë i ligjit dhe më pas është prezantuar me të tjerët. Para se të fillojë të japë mësim, Jezusi dëshiron të mësojë dhe me këtë rast ai dëshiron vetëm t'u japë mësuesve të ligjit kënaqësinë e të pasurit një nxënës të shkëlqyer.

Në jetën publike kjo përvujtëri merr përmasa më të gjëra. Para së gjithash, Jezusi e merr shpërblimin nga dikush tjetër. Ai është dërguar në tokë nga Ati dhe mund të përdorë këtë origjinë supreme të misionit të tij apostolik për të hequr dorë nga përdorimi i ndonjë autoriteti njerëzor. Megjithatë, ashtu siç dëshiron të lindë nga një grua dhe kështu të lidhet me gjithë njerëzimin, po kështu dëshiron të lidhë ushtrimin e fuqive të tij mesianike si një njeri, me synimin për t'u referuar të gjithë traditës që i parapriu.



Kështu Jezusi kthehet nga Pararendësi dhe pagëzohet prej tij. Sigurisht që pagëzimi nuk mund të përfaqësojë për Shpëtimtarin as një pastrim dhe as një kthim në besim të zemrës. Por virtyti shenjtërisë i gjestit të kryer nga Gjon Pagëzuesi përfaqëson në këtë rast të jashtëzakonshëm inaugurimin e një jete të re, të jetës apostolike. Në faktin që Jezusi donte të merrte nga një tjetër kushtrimin solemn të misionit të tij si shpëtimtar, ekziston një akt jashtëzakonisht domethënës përvujtërie, po aq domethënës sa ai që e kishte shtyrë të mësonte nga goja e Marisë lutjet drejtuar drejt qiellit Atit. Virgjëra e kishte drejtuar atë në jetën e brendshme, Gjon Pagëzuesi e ka për detyrë ta shtyjë atë në jetën baritore. Prandaj Gjoni heziton përpara se të kryejë një akt kaq të guximshëm, ai proteston që rolet duhet të ndryshohen dhe se do të ishte radha e tij për të marrë pagëzimin nga Jezusi, por Shpëtimtari ngul këmbë në kërkesën e tij të përvuajtur «Lëre tani! Sepse kështu na ka hije të kryejmë çdo gjë që përkon me vullnetin e Hyjit»(Mt 3, 15). Gjoni duke pagëzuar, dhe Jezusi duke u pagëzuar, përmbushin pra «drejtësinë» e Besëlidhjes së Vjetër, duke inauguruar mbretërinë mesianike. Ai që ul kokën përpara profetit të fundit, bën një akt nënshtrimi ndaj Besëlidhjes së Vjetër, premtimet e së cilës dëshiron t'i mbajë. Ai gjest njerëzor përkushtimi, ratifikohet menjëherë nga një manifestim hyjnor, me të cilin Ati lavdëron atë që e përul veten dhe e shpall si Birin e tij të dashur, ndërsa Shpirti i Shenjtë zbrit mbi të, që ai të kryejë misionin e tij. Është e qartë se Jezusi me të vërtetë merr nga qielli investimin e tij mesianik dhe forcën për ta realizuar atë. Megjithatë, pavarësisht se është Zot, ai përkulet para një njeriu që është përfaqësuesi i qiellit, aventura më e jashtëzakonshme e të gjithë shekujve fillon me aktin e përvujtërisë së një pagëzimi.

Në shkretëtirë Jezusi tregon një përvujtëri edhe më të veçantë, duke iu ofruar tundimeve të Satanit. Ai e lejon atë engjëll të rënë në tmerrin e gjallë të mëkatit, t'i afrohet atij dhe t'i flasë shpirtit dhe imagjinatës së tij. Do të dukej më e natyrshme që një Bir i Hyjit të mos e lejonte veten të pyetej nga djalli dhe ta ndalonte të vihej në kontakt me aftësitë dhe ndërgjegjen e tij. Por Jezusi, për të fituar zemrat e njerëzve për Zotin, e pranon këtë takim poshtërues, ai toleron ndërhyrjen e djallit. Për të luftuar më mirë ndikimin e Satanit në shpirtin, ai vetë ofrohet në manovrat e tij duke e lejuar veten të përballlet me sugjerimet e tij. Më vonë ai do të ketë gjithashtu përvujtërinë për t'u thënë apostujve të tij se ai vetë, shenjtëria e personifikuar iu nënshtrua provës së tundimit, në fakt vetëm ai mund të ketë rrëfyer këtë skenë që nuk kishte dëshmitarë. Po të mos e kishte thënë vetë, askush nuk do të guxonte të mendonte se kishte arritur në një pikë të tillë poshtërimi.



Një shërbim i përvujtë!

Mund të themi se e gjithë jeta publike e Jezusit ka qenë një shërbim i përvuajtur. Jezusi vihet totalisht në dispozicion të dishepujve dhe të turmës. Zemra e tij e butë dhe e përvuajtur është e durueshme ndaj ngadalësimit të besimit që kanë si dishepujt po ashtu turma që e ndjek, të cilët kanë një besim të lëkundshëm ndaj mesazhit të Jezusit.

Të gjithë shërimet mrekullibërës për të janë një shërbim modestie. Nuk i bën mrekullitë sepse dëshiron të duket apo të fitojë vëmendje popullore. «Kur kryetari i tryezës e kërkoi ujin e kthyer në verë - e nuk e dinte nga vinte - shërbyesit, që e kishin mbushur ujin, e dinin - kryetari i tryezës e thirri dhëndrin dhe i tha: Çdo njeri më parë vë në tryezë verën e mirë e, kur t'i nxehtë pija, sjell verë më të keqe. Ti e paske ruajtur verën e mirë deri tani!»(Gjn 2, 9-10). Në një fare mënyrë mrekullia që bëri Jezusi injorohet, sepse shërbyesit e dinin se ishte ai i cili e kishte shndërruar ujin në verë.

«Kur Jezusi përsëri kaloi me barkë në anën tjetër, ngarendi tek ai turmë e madhe populli. Ai zuri vend në breg të detit. Erdhi një nga kryetarët e sinagogës, që quhej Jair, e, kur e pa, ra në gjunjë para tij dhe i lutej shumë: E kam vajzën në fill të vdekjes! Eja, vëri duart mbi të që të shërohet e të jetojë! Jezusi shkoi me



të. [...]Ndërsa Jezusi ende po fliste, erdhën prej shtëpisë së kryetarit të sinagogës dhe i thanë: Vajza jote vdiq. Pse ta trazosh më Mësuesin? Kur Jezusi dëgjoi ç'thanë, i tha kryetarit të sinagogës: Mos ki frikë! Ti vetëm beso!» (Mk 5, 21-24, 35-43). Jezusi edhe pse dëgjon çfarë kishte ndodhur, e inkurajon që të ketë besim, sepse mallëngjehet nga dhimbja e tij, dhe menjëherë dëshiron të përmbushë mrekullinë. «Hyri dhe u tha: Pse bërtitni e vajtoni? Fëmija nuk ka vdekur, por fle» (Mk 5, 39). Nëse do kishte kërkuar që të kishin sukses veprimet e tija do ishin ndryshe, do i kishte pyetur mirë nëse është e sigurt që ka vdekur, mund të ju ishte përgjigjur që mos qani e vajtoni se un do e ringjall. Asnjë nga këto veprime nuk i bëri, por me shumë përvujtëri ju thotë që fëmija nuk ka vdekur por fle. Ai dëshiron ta zbusë

ngrihen gjymtyrët. [...]Nëse mund të bësh gjë, na ndihmo! Ki mëshirë për ne! Nëse mund të bësh gjë... ! - iu përgjigj Jezusi - Gjithçka është e mundshme për atë që beson! Menjëherë babai i djaloshtit tha me zë të lartë: Besoj, por më ndihmo ti të besoj!»(Mk 9, 17-23). Nuk është përgjigja që prisnim logjikisht, sepse me pyetjen që babai i djalit i bën Jezusit, duket se vë në dyshim fuqinë e Mesisë, edhe pse ai e vë në dyshim këtë gjë përsëri Jezusi nuk e pohon fuqinë e tij, por atë të atyre që kanë besim. Meritën e shërimit edhe para se ta kryejë, ai ia atribuon besimit të bashkëbiseduesit. Pikërisht menjëherë u përgjigj, besoj, ndihmoje besimin tim të vogël. Siç vërehet Jezusi bën kaq mirë duke fshehur fuqinë e tij të mrekullueshme.

E vërejmë qartë se Jezusi në tokë nuk ka ardhur



mrekullinë e gjestit të tij. Ose për shembull shumimin e bukëve një gjest që dishepujt e tij e dinin se kishte ndodhur mrekullia. Kur ndahet buka nuk e ndan Jezusi, por ju thotë nxënësve të vet t'ua vënë para njerëzve, (krh. Mk 6, 41). Kërkon një bashkëpunim që mund edhe të mos ta kërkonte. Me pak fjalë mrekullitë që ai përmbush nuk i përmbushë vetëm por kërkon bashkëpunimin e të tjerëve, bashkëpunimi me të tjerët është akti i besimit që ato kanë sepse shërimin ai ja atribuon besimit të personit që i është lutur. Një pjesë tjetër është ajo e babait që kishte djalin me djallin në trup.

«Mësues, e solla te ti djalin tim që ka në trup një djall që s'e lë të flasë. Kudo e kap, e shkapet andej këndeje e djali shkumon e kërcëllon dhëmbët dhe i

për të treguar fuqinë e tij, por ka ardhur për të na propozuar vetën jo si teori por si përvojë. Ai vetë është doktrina që ne të krishterët duhet të ndjekim, duhet të mësojmë nga Ai që është zemër butë dhe i përvuajtur. Jezusi e shpëtoi botën jo me dhunë e me luftë por me butësi. E ne si të krishterë, sa e ndjekim dhe e imitojmë këtë model? Jezusi është Mësuesi për excellencë i përvujtërisë, siç është cituar edhe më sipër në pjesët biblike, Jezusi e fsheh çdo pushtet të tijin, qëndron në përvujtërinë më të madhe të mundshme. Kjo është udha që duhet të ndjek i krishteri, duhet të sodis dhe të imitoj Zemrën e Jezusit që është zemër e butë dhe e përvuajtur.

□



“LA NATIONE ALBANESE”, TRIBUNË E PASQYRIMIT PËR ÇËSHTJEN E PAVARËSINË E ATDHEUT!

*Konferencë Shkencore Ndëruniversitare Mbi arbëreshët:
Anselmo Lorekjo dhe Terenc Toçi - Universiteti Shkodrës “Luigj Gurakuqi”
Shkodër, 07/06/2024*

Me datë 7 qershor 2024, në sallën e konferencave në bibliotekën e Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, u mbaj konferenca ndëruniversitare kushtuar arbëreshëve, Anselmo Lorekjo dhe Terenc Toci, rolit dhe kontributit e tyre dhe të diasporës arbëreshe në lëvizjen politike dhe kulturore për pavarësinë kombëtare shqiptare. Nisma u organizua nga Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi” me dy fakultetet e tij Fakulteti i Shkencave Shoqërore dhe Fakulteti i Drejtësisë, në bashkëpunim me Njësinë Kërkimore-Studimore për Arbëreshët, Arvanitët dhe Arbëneshët e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe nën kujdesin dhe mbështetjen e veçantë të Arqidioqezës Metropolitane Shkodër-Pult dhe të Fondacionit Universitar “Françesko Solano”.

Konferenca mbledhi studiues të Universitetit të Shkodrës Luigj Gurakuqi, Akademisë së Shkencave, Universitetit të Calabrisë, Universitetit Roma III, Universitetit të Palermos dhe Universitetit të Chietit-Pescara.

Nxjerrja në pah e rolit dhe kontributit të

Anselmo Lorekio dhe Terenc Toci dhe të diasporës arbëreshe në lëvizjen politike dhe kulturore për pavarësinë kombëtare shqiptare shërben jo vetëm si nxitje për kërkime të mëtejshme rreth këtyre dy figurave me shumë ndikim në jetën publike dhe politike të kohës por edhe si një mundësi për të shkruar drejt historinë e vendit tonë.

Konferencën e përshëndeti Rekorja e universitetit, prof. dr. Rajmonda Këçira, e cila vuri theksin te rëndësia e organizimit të konferencave shkencore ndëruniversitare dhe falënderoi për pjesëmarrjen e profesorët dhe të pranishmit. Përshëndeti gjithashtu Arqipeshkvi metropolit i Shkodër-Pult, Imzot Angelo Massafra, duke vënë theksin te arbëreshë, Lorekjo dhe Toçi të cilët kanë qenë të frymëzuar nga dashuria për Shqipërinë dhe kanë shënuar një pjesë të historisë sonë.

Gjatë konferencës, referuesit vunë theksin të jeta dhe vepra e Anselmo Lorekios si themelues i gazetës “Kombi Shqiptar” (“La Nazione Albanese”), tribunë e pasqyrit të përpjekjeve të mëdha për çështjen e Pavarësinë e atdheut, si dhe





me gjendjen e shqiptarëve kudo ndodheshin ata si dhe në shkrimet e tij në të cilat ka trajtuar çështje të ndryshme të historisë, gjuhës shqipe dhe letërsisë.

Me referimet për arbëreshin Terenc Toçi doli në pah lidhja e tij me Shkodrën, puna e tij për një Shqipëri të pavarur, për ngritjen e flamurit në vitin 1911, për themelimin e gazetës "Taraboshi", ndër të parat gazeta politike në Shqipëri si dhe shërbimi i tij si deputet, si prefektë e si ministër.

Një moment i veçantë gjatë konferencës iu kushtua dorëzimit të titullit "Profesor nderi" i universitetit të Shkodrës Profesoreve Francesco Altimari dhe Mateo Mandala për kontributin dhe përkushtimin ndër vite në gjuhësinë shqiptare, për vlera të çmuara si studiues në fushën e albanologjisë si dhe për kontribut akademik pranë këtij universiteti.

* * *

PËRSHËNDETJE – MONS. ANGELO MASSAFRA

Të nderuar pjesëmarrës,
E nderuar Rektore,
të nderuar profesorë dhe akademikë,
të dashur studentë, kam kënaqësi të veçantë të

përshëndes sot konferencën kushtuar dy arbëreshëve të mi, **Anselmo Lorekio dhe Terenc Toci**. Ju e dini të gjithë që jam arbëresh dhe për këtë jam kujdesur me shumë dëshirë për organizimit e kësaj Konference që mbledh në diskutim profesorë dhe akademikë, studiues të jetës dhe veprës së Lorekios dhe Tocit, për të nxjerrë në pah rolin dhe kontributin e tyre dhe të diasporës arbëreshe në lëvizjen politike dhe kulturore për pavarësinë kombëtare shqiptare.

Dëshiroj të falënderoj me këtë rast të gjithë referuesit dhe studiuesit e në mënyrë të veçantë

profesor Altimarin dhe prof Mandalanë për impenjimin e veçantë për organizimin e kësaj Konference e cila uroj të nxisë kërkimet e mëtejshme rreth këtyre dy figurave.

Arbëreshët, Lorekio dhe Toçi i lidhin jo vetëm

ngjarjet dhe kohët por edhe kontributi i madh në lëvizjen politike për pavarësi. Si juristë e si politikanë por edhe si shkrimtarë të frymëzuar nga dashuria për Shqipërinë ata kanë shënuar një pjesë të historisë sonë.

Lorekio ishte themelues i gazetës "Kombi Shqiptar"("La Nazione Albanese"), tribunë e pasqyrim të përpjekjeve të mëdha për çështjen e Pavarësinë e Atdheut, si dhe me gjendjen e shqiptarëve kudo ndodheshin ata. Në shkrimet e tij ai ka trajtuar çështje të ndryshme të historisë, gjuhës shqipe dhe letërsisë.

Toçi gjithashtu, punoi për një Shqipëri të pavarur, për ngritjen e flamurit në vitin 1911, për themelimin e gazetës "Taraboshi", ndër të parat gazeta politike në Shqipëri. Shërbeu si deputet, si prefektë e si ministër. Thonë se Toçi ishte njeriu i cili edhe pse e dinte se do të arrestohej nga regjimi i kohës nuk iku nga vendi, pasi siç thoshte dhe vetë "Pse të ik nga vendi im? Unë nuk ndihem se kam bërë faj, pasi gjithë jetën ia kushtova Shqipërisë".

Të dashur profesorë, akademikë dhe studiues, jua besojmë ju plotësimin e shkrimeve rreth Anselmo Lorekio dhe Terenc Tocit dhe uroj që gjetjet tuaja të shkruhen e të lexohen sa më shumë.

Punë të mbarë konferencës. Faleminderit


Paulina Guli Hoti





**“ZOJA E KËSHILLIT TË MIRË”,
NGRITET NË DINJITETIN E BAZILIKËS MINORE**

*Dikasteri për Kultin Hyjnor
dhe Disiplinën e Sakramenteve*



Romë, Prot nr. 721/23

Drejtuar Arqipeshkvisë - Shkodër-Pult

Nisur nga letra e Shkëlqësisë së Tij Imzot Angelo Massafra, Arqipeshkëv i Shkodër-Pult, që mban datën 4 nëntor 2023, me të cilën ai bëhej garant i lutjeve dhe i kushteve të klerit dhe të besimtarëve, Dikasteri për Kultin Hyjnor dhe Disiplinën e Sakramenteve, në bazë të pushtetit të veçantë dhënë nga Papa FRANÇESKU, shenjtërores në qytetin e Shkodrës, kushtuar për lavdi të Hyjit së Lumes Mari Virgjër, Nënës së Këshillit të Mirë, me gjithë zemër i jepet titulli dhe dinjiteti i BAZILIKËS MINORE me të gjitha të drejtat dhe lejet liturgjike që i përkasin, meqë është respektuar me të vërtetë gjithçka që duhej respektuar sipas Dekretit “De Titulo Basilicæ Minoris”, shpallur më 9 nëntor 1989.

Pavarësisht çdo dispozite për të kundërtën.

Nga selia e Dikasterit për Kultin Hyjnor dhe Disiplinën e Sakramenteve, 22 prill 2024.

Arturo Kard. Roche
Prefekt

† **Vittorio Francesco Viola O.F.M.**
Arqipeshkëv Sekretar



FORMIMI I BREZIT TË RI MBI VLERAT E KRISHTERA

*Fjala e Mons. Massafra në Asamblenë e XV KKEKSH
Universiteti "Zoja e Këshillit të Mirë" në, Tiranë, dt. 8 qershor, 2024*

Të dashur, mirë se kemi ardhur në asamblenë e pesëmbëdhjete të KKEKSH-it.

Sapo kemi festuar festën e Zembrës së Shenjte të Krishtit dhe sot Festojmë Zembrën e Papërlyer të Zojës, dy festa që na kujtojnë neve që i dedikohemi edukimit se pasioni ynë buron nga dashuria e Zotit dhe përmbushet vetëm kur me gjithë zemër nuk kursehem për të mirën e brezit të ri. Për këtë përfitoj nga rasti edhe të ju falënderoi për përkushtimin tuaj të palodhur.

Sikurse do të ndjekim në vijim, kjo Asamble do të paraqesë disa ndryshime të rëndësishme në përbërjen e Komisioni tonë por edhe të sekretariatit, prandaj në një fare mënyre është një bashkëndarje për përvojën e deritanishme të cilën të gjithë në s bashku kemi jetuar dhe një projektim në të ardhmen që do të ndërtojmë bashkërisht.

Komisioni Kombëtar, nga Asambleja e fundit, sipas Planit Strategjik dhe në përgjigje të kërkesave nga vetë shkollat, ka zhvilluar disa aktivitete, mes të cilave duhen veçuar sigurisht, konferenca e datës 6 dhjetor me pjesëmarrje të gjerë ndërkombëtare. Temat e diskutuara aty, sikurse është përmendur edhe në asamblenë e janarit, janë me interes të veçantë për çështjen e edukimit katolik dhe secila prej shkollave të pranishme, jam i bindur se është një hulumtues i dimensioneve të reja të problematikave në rang kombëtar që ata vet, të bashkuara e kanë. Kjo është një punë që po çohet dhe duhet çuar përpara.

Shumë institucione të rrjetit tonë po përjetojnë momente vështirësish, mungesë fëmijësh, mungesë mësuesish, vështirësi ekonomike etj..

Dëshiroj t'ju them që çdo krizë është edhe një sfidë dhe mundësi për të parë me thellë e më larg. Për të transformuar realitetet tona edukative dhe për të përmirësuar shërbimin tonë ndaj brezit të ri.

Organizata ndërkombëtare e Edukimit katolik OIEC sapo ka botuar në dokument të përbashkët me kongregatat rregulltare dhe me UNESCO mbi angazhimin për Paktin Edukativ Global. Këtë dokument që ju kemi dërguar ditët e fundit, duhet që ju si drejtues ta lexoni, ta thelloni dhe mbi të të mbështesni Planin tuaj Pastoral Shkollor dhe punën me komunitetin dhe famullitë në territoret ku ndodheni. Pasi synimi i institucioneve tona, kopshteve dhe shkollave nuk është vetëm shkollimi por formimi i brezit të ri mbi vlerat e Krishtera, ndaj



edhe institucionet tona duhej të dallohen nga një oferte e qarte edukative-pastorale që motivohet edhe nga pakti edukativ global tashme i përqafuar edhe nga UNESCO. Ndaj duhet të jemi me guximtare dhe të qartë në propozimet tona edukative.

Këtu me lejoni të bëj një vërejtje: Edhe pse këto evente që bashkë kemi vendosur dhe që janë në linjë me misionin tonë dhe dëshirat që ju vet keni shprehur dhe shkruar në planin strategjik, kanë paraqitur një pjesëmarrje jo të kënaqshme. "mungesa nuk është as mire as e drejte".

Kemi nevojë të rritemi si rrjet. Aktiviteti i radhës : shkolla verore për ekipet drejtuese që behët në Shkodër me 3-6 korrik shpresoj të jetë një mundësi tjetër që do të ndihmojë rritjen e cilësisë edukative të rrjetit tonë.

Eventët, aktivitetet apo projektet që ndërmerr KKEKSH janë përgjigje nevojave, sfidave dhe problematikave që vetë entet tona paraqesin dhe tashme të shprehura edhe në planin strategjik që ju vetë keni hartuar me ndihmën e Bordit drejtues. Por



edhe të bashkëndara ne Asamblëtë tona.

Do të dëshiroja që kjo asamble, nder të tjera, të shërbejë edhe si një mundësi për të diskutuar arsyet dhe për të propozuar mënyrat me të mirë që të ecim bashkë. Nëse ne kërkojmë gjithëpërfshirje në sistemin arsimor vendas, duhet së pari të rrisim bashkëpunimin dhe kohezionin mes nesh.

Gjatë shqyrtimit të punës së realizuar nga Asambleja e kaluar, kam vënë re se jemi më pranë arritjes së objektivave tona strategjike. Aktualisht, KKEKSH është një zë i cili ftohet në tryeza diskutimi për arsimin dhe aty shtrun gjithë çështjet e mbledhura nga vetë ju. Ky fakt shënon një hap të rëndësishëm në rrugën për krijimin e një klime më miqësore me Ministrinë që të arrihen ato fare neve kërkojmë.

Para së ta mbyll, dua ta vendos sërish theksin, ndoshta duke përsëritur vetveten, të fakti së Asamblëtë tona janë ndryshe prej atyre të zakonshmeve: Këtu nuk ka një publik që dëgjon dhe një panel që flet, por një panel që dëgjon dhe flet dhe një publik që flet edhe dëgjon.

Prandaj, për secilën prej çështjeve të shtruar me lart apo që do të shtrohen edhe në

vijim nga Koordinatorja, duke qenë së jemi edhe përpara kalimit të stafetës nga motër Teuta të një koordinatori i ri Padre Michele, jeni të ftuar të pyesni, diskutoni, e të gjejmë së bashku zgjidhje.

Falënderoj motër Teutën për përkushtimin, për hapat që kemi bërë, uroj nga zemra p. Mikelit punë të mbarë. Dhe e falënderojmë se ka pranuar këtë angazhim që ia kemi besuar, e falënderojmë eprorit që ia ka lejuar. Duke i uruar punë të mbare asamblesë, Ju falënderoj të gjithëve!

+ Angelo Massafra





MIRËNJOHJE PËR MONS. ANGELO MASSAFRËN PËR KONTRIBUTIN E MADH QË NA DHA NË RUAJTJEN E KUJTESËS DHE DOKUMENTIMIN E KRIMEVE TË KOMUNIZMIT

Fjala e mbajtur në Muzeun e Kujtesës në Shkodër dt. 22.05. 2024, me rastin e nderimit me Certifikatën e nderit “Mirënjohje e Martirëve të Lirisë” dhënë Shkëlqesisë së Tij, Mons. Angelo Massafres!

Të nderuar Klerikë!
Të nderuar të mbijetuar të diktaturës ju që
përballuat vuajtjet e komunizmit!
Të nderuar qytetar të Shkodrës!

Fort i ndershëm dhe i respektuar Shkëlqesi
Monsinjor Angelo Massafra!

Mire se keni ardhur në këtë ceremoni nderimi për
një arbëresh nga “gjaku i shprishur,” për një përçues
e mësues i palodhur në shërbim të besimit në Zot
Jezues, dhe të rehabilitimit të fesë katolike në
Shqipërinë postkomuniste.

Për të nderuar aktivistin e palodhur Mons.
Massafren që përkrah besimit fetar, ky personalitet i
madh i kohëve tona dha në mbrojtje të kujtesën
kombëtare, dhe dokumentimin e krimeve të
komunizmit në Shkodrën e martirëve të lirisë e të
qëndresës antikomuniste.

Ndjehem shumë i privilegjuar, dhe me përlësi
ulem përpara veprës tuaj imzot Angelo, por fati e
deshi që unë pinjoll i një familje që provoi tre
diktaturat fashiste, naziste, komuniste në drejtimin e
Unionit Mbarëkombëtar Integritimit të Burgosurve
dhe të Përndjekurve Politikë të Shqipërisë të drejtoi
këtë event madhështor, dhe të flas për veprën tënde
fetare e kombëtare dhe njerëzore.

Pak muaj ma parë me Ju vizitua Shenjtërinë e tij,
mikun e madh të shqiptarëve, nga toka Arbënore në
Selinë e shenjte Papa Françeskun. Vizita e jonë
konsakroi rëndësinë e të kaluemes tonë tragjike dhe
synoi njëkohësisht përkrahjen e Selisë së shenjte ndaj
dënimit të krimeve të komunizmit.

“Gjaku i shprishur” ju thirri ju imzot që me hapjen
e kufijve shqiptarë nga ndërrimi i sistemit Ju me
vizionin dhe misionin tuaj të shenjte të ju kërkonin it
eporëve tuaj që të vinit si misionar në Shqipërinë
tonë të përbashkët. Dhe përfundimisht arritët në
vendin e Skënderbeut 1993 Veprimtaria e juaj
baritore si detyrë e parë, tek famullia pranë
komuniteteve të krishtera në Troshan dhe Fishtë, në
Fishtën Gjergjit të madh Homerit shqiptar ju u bëtë
mësuesi i parë për formimin e të rinjve, mësues i
Novicëve në provincën e rilindur të fretërve minor
në Shqipëri pranë kuvendit të Lezhës. Në dhjetor
1996 u emëruat Ipeshkëv Dioqezës së Rrëshenit dhe
administrator Apostolik i Lezhës së kryetrimt,
mbrojtësit të krishterimit heroit tonë kombëtar, Gjergj
Kastrioti Skënderbeu, dhe në vitin e zi të 97 u

shuguruat Ipeshkëv nga Shën Gjon Pali i II në
Bazilikën e Shën Pjetrit në Vatikan, ku mbas 10
muajsh pas vdekjes Arqipeshkevit të Shkodrës Frano
Ilija u emëruat Administrator Apostolik së
Arqipeshkëvisë së Shkodrës dhe Sapës. Krahas
detyrave të rëndësishme nga Ati i shenjte Ju u
zgjodhët anëtar i Këshillit Papnor në vitin 2005
pikërisht me 25 janar , Selia e shenjte dekretion
bashkimin e Dioqezës se Pultit me Arqidioqezën
Metropolitane të Shkodrës më emrin e ri
Arqipeshkevia Shkodër –Pult dhe kështu Imzot
Massafra bëhet Arqipeshkëv i Shkodër Pultit. Si
President i Konferencës Ipeshkvore Ju treguat kujdes
veçanërisht në fushën e edukimit, sporteve dhe
animacionit si dhe dialogut ndërfeetar. Ju u bëtë
promotori i riorganizimit të kishës shqiptare duke
afruar shërbimet e nevojshme duke punuar për
kujdesin e thirrjeve , duke i restauruar dhe ndërtuar
kishat e shkatërruara, për tu afruar bashkësisë të
krishtera , vende të shenjte të denja dhe duke
gjallëruar në aspektin e asistencës që veçanërisht në
vitet e para ishte shumë i nevojshëm. Gjatë shërbimit
tuaj Ipeshvor, për shkak të funksionit që kishit, janë
të shumta veprat tuaja si “Fshati i Paqes” rrëzë
Taraboshit që e krijove për të mirëpritur refugjatët e
luftës së Kosovës, duke pasur një bashkëpunim
midis Zyrës për Drejtësi dhe Paqe në Dioqezën dhe
komunitetit të Sant Egidio që përfshin gjithashtu të
krishterë ortodoks, dhe mysliman të pranishëm në
territorin e Arqioqezës. Ku nuk u gjinde Imzot me
misionin tuaj, tek projekti “Shpresa në Shkodër,” në
ndihmë të personave me aftësi ndryshe në kampet
verore, një ndihme të madhe dha e në fushën e
bamirësisë. Besnik ndaj motos Ipeshknore, në
pajtimin e gjaqeve për gjakmarrje. Ti i solle paqen
Shkodrës në vitin 1998 në një moment të një lufte
civile që mund të çonte dhe luftë fetare. Ju përveç
punës baritore të kishës, keni publikuar dy botime
“Pajtohuni me Hyjin 2002” dhe “Dhuratë dhe
Angazhim 2016” dhe katër letra baritore të botuar
nga Shkëlqesia e juaj “Ati na pret ti dalim përpara,
1999” “Ju dua të gjithëve në Jezu Krishtin 2002”
“Ata që Soditim.. “ Ne e Kumtojmë 2006 “ Gëzimi
i Dëshmisë 2017” Jeni kujdesur si drejtor i
përgjithshëm, për gazetën periodike “Fjala e
Paqes” dhe Revista “Kumbona e Diellës “ ka
punuar të biografitë për Vincens Prenushi dhe 37
shokëve martirë të lumturuar me 5 nëntor 2016 e si



President i Gjykatës Kishtare për procesin e kanonizimit të 40 shërbëtorëve të hyjit “Martirët shqiptar vranë gjatë diktaturës që ka filluar me 10 nëntor 2002 dhe përfundoi me 8 dhjetor 2010. Përkushtimi i juaj kulturor nuk ndalet vetëm me botime, por kenë qenë promovues i Radio Maris në Shqipëri.

Ka qenë këshilltar i disa dokumentarëve të dedikuar figurave kombëtare shqiptare si Gjon Buzukut, Frang Bardhit, Pjeter Bogdanit,

Ti i dashur Massafra erdhe në Shqipërinë postkomuniste se të tërhoqi “Gjaku i shprishur që të thërrisni rrënjët e tua arbëreshe, ku për besimin në Zot e fe ishin pushkatuar besimtare shqiptar. Por ti gjete këtu shpirtin e besimit në Zot. Komunizmi jetën jua mori, por besimin jo, ti gjete foton e Jezuesit se si e mbronin besimtarët sokolesha shkodrane mbas fotos së diktatorit, si e mbronin nga shkatërrimin Zojën e Bekueme e shumë relike të shenjta të besimit në Zot. Dhe me këto dhe me ruajtjen e koleksioneve të kohës së lashta na krijove muzeun e historisë besimit dhe të kishës katolike.

Faleminderit për ketë dhuratë historike që i ke lënë Shkodrës dhe Shqipërisë besimit katolikë shqiptar.

Ju ndoqët postulatit e Shën Gjon Pali II ku në aeroportin e Rinasit në vizitën historike 1993 ju drejtua popullit shqiptar” Demokracia nuk ndërtohet mbi harresën”.

Falë përkushtimit tuaj sot ndodhet e pa rrënuar godina e burgut të Spaçit, ju shkuat deri në Amerikë

dhe s bashku me fondacioni Drejtësi dhe Paqe e shpëtuan këtë simbol të kujtesës.

Ti imzot, dhe ne të përndjekurit politikë presim një përgjigje përse nuk u dënuan kriminelet që vranë klerin shqiptar e në veçanti klerin katolik e mbi 6000 shqiptar që sot nuk kanë një varr në token e tyre.

Shoqëria shqiptare nuk do të shërohet kurrë nga rrjedhimet e murtajës komuniste, përse kohë që nuk del në shesh e vërteta. Ju punuat me misionin tuaj për të vërteten.

Ju kishit Madhështi shpirtërore kur i kërkuat politikës së papërgjeshme shqiptare dënimin e krimeve të komunizmit me ligj siç e kanë vendet evropiane.!

Historia e popullit shqiptar nuk njeh një rast të vetëm kur kleri dhe besimtarët katolikë të mos kenë qenë pjesëmarrës, e në shumë raste udhëheqës, në kalvarin shumë shekullor të vendit tonë, e në luftërat kundër armiqve kërcënues; dhe tashti vonë, në forcimin e një Shqipërie të lirë që përpiqet me qenë evropiane. Kjo falë punës misionit tuaj.

Sot, ëndrra e keqe ka përfundua! Por ne gjendemi para një procesi shërimi në vendin tonë, para detyrës së rendit të rindërtimit moral për të gjithë ne. Jo vetëm ata që janë përgjegjës direkt për krimet e kryejmë, por edhe ata që margjinalisht ndihen fajtorë, – sepse kanë heshte dhe këtu ka një numër të madh!- duhet të kalojnë nëpër procesin e rivlerësimit të përgjegjësive të tyre, të qëndrimit të tyre imoral ose amoral në ditët e vështira, kundrejt grupit shoqëron numerikisht ma



të vogël, por ma të persekutuar se të tjerët, popullsisë katolike shqiptare.

Për fat të mirë, erdhi zhvillimi i ngjarjeve në Shqipëri: shpresa e ushqyem me besim.

Tashti ndijohet këmbena e kishës përsëri; dhe përsëri myezini thërret besimtarët për adhurim të Zotit.

Sot, shqiptarët luten, meditojnë, shpresojnë përsëri. Sot, po zbret vala e vuajtjeve që urrejtja krijoi në marrëzinë e vet, dhe shpresojmë se do të zëvendësohet me një frymë të re, të heshtur por plot gjallëri, me mirëkuptim, por pa harrua të kaluemen. Sot, ish të persekutimet kanë përbuzë hakmarrjen, *një fitore morale shqiptare me përpjesëtime historike, e që këput zinxhirin e hakmarrjes*. Sepse falja e fajit ka zanafillë hyjnore, ashtë karakteristike e shpirtmadhësisë, dhe ky ashtë një ogur i mirë, një shpresë e re që shoqëria shqiptare ka vendos mos përsëritjen e tragjedisë së kalueme. Sot, Kisha Katolike shqiptare, viktima kryesore, deklaron: “Ne, nuk gjujkojmë! “Te përndjekurit thërrasin njëzëri Hakmarrje Jo, Drejtësi Po. Pa drejtësi nuk ka liri, pa liri nuk ka demokraci.

Ja kushtove vendit tim, imzot, vendit tënd Shqipërisë 31 vite jetë, 31 vite ma të mirat ja dhe atdheut tonë të përbashkët Shqipërisë.

Ju u bëtë bashkëpunëtor më ne të vuajturit e diktaturës, mësimet e tua, vizioni i juaj, i të vërtetës të paqes, dhe të lirisë do të ngelet postulat për ne. Kërkesa e juaj të dënohet krimet e komunizmit ishte një kambana për të vërteten pa të cilën ne nuk mund të ndërtojmë sistemin e vlerave sistemin e qytetarit të lire, por dhe një këmbena ndaj papergjeshmerisë së politikanëve shqiptar që në vend që të dënonin krimin ju bashkuan heshtjes ndaj kimit. Heshtja e tyre vret njëlloj si plumbat e xhelatëve të diktaturës dje.

Mirënjohjen tonë të thellë Imzot Angela Massafres për kontributin e madh që jep në ruajtjen e kujtesës dhe dokumentimin e krimeve të komunizmit, dhe po të vepronte klasa politike postkomuniste si Ju me përkushtimin e Shqiptarit të madh e sensibilizues fati i të përndjekurve politikë shqiptarë dhe i shoqërisë shqiptare, sot do të ishte ndryshe.

Sot do të kishim një Shqipëri demokratike, një Shqipëri të lire një Shqipëri të paqme.!

Të besojmë dhe të shpresojmë!

Faleminderit Imzot Angelo Massafra, ti u bërë pjesë e plejadës të njerëzve të shquar të kombit tim, të kombit tonë”.

Besim NDREGJONI

* * *

Fjalimi i Imzot Massafres:

ÇERTIFIKATË NDERI 22/05/2022

I nderuar Z. **Besim Ndregjoni**

Te nderuar Anëtare e Presidencës se Unionit Mbarëkombëtar
Përsëritës e falënderoj të pranishëm.

Është nder për mua që marr këtë certifikatë nderi, për të cilin falënderoj organizatorët e eventit z. Besim.

Angazhimi im në këtë fushë kaq delikate buron nga dy faktorë, që i konsideroj jashtëzakonisht të rëndësishëm: vlera e drejtësisë dhe ajo e shenjtërisë.

Jam shumë i bindur, siç mëson Kisha katolike, se drejtësia është njëri nga virtytet më të rëndësishëm, në fakt ajo është pjesë e virtyteve kryesore, bashkë me maturinë dhe përmbajtjen. Katekizmi në nr. 1807 thotë: Drejtësia është virtyti moral, që ka të bëjë me vullnetin e vazhdueshëm dhe të vendosur për t'i dhënë Zotit dhe të tjerëve atë që atyre u takon.

Martirët e Lirisë, të Fesë dhe të Atdheut kishin një pasuri vlerash njerëzore e fetare, që nuk mund të mos përfshinin virtytin e Drejtësisë, në kuptimin e shprehur nga teksti i Katekizmit të Kishës Katolike që sapo citova. Natyrisht kjo vlen jo vetëm për Martirët katolikë, por edhe për të tjerët. Padyshim që për Martirët katolikë ky virtyt shërbeu edhe si njëra nga arsyet e vlefshme për lumnimin e tyre.

Shenjtëria. Është ai qëndrim themelor, i cili, ndërsa e orienton krejt jetën tonë kah Zoti, në të njëjtën kohë nuk distancohet nga fatet e botës, por pikërisht për botën lutet, përgjërohet dhe, si në rastin e Martirëve tanë, i shtyn njerëzit që të japin jetën e tyre për një të mirë më të madhe: të mirën e përbashkët dhe shpëtimin e popullit.

Dhe prandaj besoj se kjo certifikatë nderi duhet t'u kushtohet më shumë atyre që dhanë jetën për liri, fe dhe atdhe... Për sa më takon mua, ajo që kam mundur të bëj këto vite ka qenë një akt drejtësie ndaj tyre, por edhe shenjtërie... në kuptimin që shembulli i tyre nuk duhet të harrohet, por përkundrazi duhet të mbahet mend që të mos i bëjmë më të njëjtat gabime; dhe sidomos që brezat e rinj të marrin nga këta shembuj guximin për t'u përballur me rutinën e përditshme të jetës pa u ikur problemeve që sot prekin atdheut tonë dhe diktaturat e reja që e kërcënojnë atë.

Në fund, bëra atë që munda me çdo lloj angazhimi, sepse jam me të gjitha efektet qytetar shqiptar dhe nuk mund t'i harroj në asnjë mënyrë rrënjët e mia, që përcaktojnë identitetin tim. Ky është edhe urimi që ua drejtoj të gjithëve, veçanërisht të rinjve: të mos i harrojmë rrënjët tona dhe të jetojmë me krenari dhe dinjitet. Ju faleminderit përsëri shumë për këtë certifikatë nderi.

† **Angelo Massafra O.F.M.**
Arqipeshkëv



NJË JETË E JETUAR PËR ZOTIN E BESIMTARËT!

*Obelisk në Lushnje në nder të kardinalit Dom Mikel Koliqi,
në vendin ku vuajti internimin në diktaturë!
Lushnje, 31.05.2024*

Në fshatin Gjazë të Lushnjës u vendos obelisku memorial kushtuar kardinalit të parë shqiptar, Dom Mikel Koliqi, në përkujtim ndaj rezistencës antikomuniste.

Obelisku prej mermeri u vendos në vendin e vuajtjeve, atje ku prifti katolik kaloi disa vite internim. Në ceremoni ishte i pranishëm ambasadori i Vatikanit në Shqipëri Luigi Bonazzi, arqipeshkv i Ardioqezës Shkodër, Angelo Massafra dhe zyrtarë lokal.

Ambasadori i Vatikanit lexoi mesazhin e papës ditën e vdekjes së Mikel Koliqit. Ndërsa bashkëvuajtesit e internimit folën mbi kujtimet e tyre dhe figurën e Koliqit.

Shtëpia ku jetoi periudhën e internimit, e rrënuar ka ende parullat komuniste. Si një dëshmi e epokës së egër të diktaturës kjo banesë mbart kujtimet e vuajtjes së jetës së Koliqit.

Dom Mikel Koliqi bëri 21 vite burg politik dhe 21 vite në internim. U lirua me amnistinë e vitit 1986. Më 28 nëntor 1994 u inaugurua kardinal në Vatikan nga vetë papa Gjon Pali II. Vdiq më 27 janar 1997.

Faja përshëndetëse e Imzot Massafres:

Hirësia e Tij Mikel Koliqi, është një nga figurat më të ndritura të Kishës katolike shqiptare, njeriu që u bë simbol i gjakut të martirëve, derdhur nga diktatura komuniste në Shqipëri.

Këtë figurë shembullore Kishtarë e Kombëtare po e kujtojmë me fjalët e imzot Klaudio Maria Çelit, ish Kryetar i Këshillit Papnor të Komunikimeve Shoqërore, i cili, si përfaqësues i Selisë së Shenjtë, gjatë vizitës zyrtare në Shqipëri në vitin 1991 e pati njohur e takuar në Shkodër dom Mikel Koliqin. Rasti që një ndër takimet e para që përfaqësuesit e Vatikanit takonin popullin dhe klerin e persekutuar, që posa kishin dal nga dimri egër i diktaturës ateiste të komunizmit.

I zgjedha pikërisht fjalët e imzot Klaudio Maria Çelit, për të nënvizuar se figura si ajo e Kardinalit Mikel Koliqi, mbeten përgjithnjë në kujtesën e njerëzve, si simbol i gjakut të derdhur të martirëve, prej diktaturës komuniste në Shqipëri. Ja si e kujtoi Imzot Çeli, vetëm dy ditë më parë, në sa përshkruante Meshën e kremtuar në Katedralen e Shkodrës, më 21 mars 1991:

“Sapo e kishim filluar Meshën, kur hyri në Kishë monsinjor Koliqi. Ishte vikari i përgjithshëm, që kishte shpëtuar gjallë nga persekutimi: fizikisht i shkatërruar, por tmerrsisht i gjallë e i fuqishëm në shpirt. Hyri në Kishë i mbajtur për krahësh nga dy të rinj. Figurë interesante, emocionuese. Madje fjala interesante nuk mjafton për të shprehur atë që ndjemë të gjithë atë çast, sepse ishte një pamje e





papërshkrueshme. Më tha: “Unë nuk dal ma prej shtëpie, por kur më thanë se ju jeni këtu, e ndjeva për detyrë të isha i pranishëm, në një çast kaq të pritur, kur përfaqësuesi i Papës asht mes nesh! Fillova homelinë. E kujtoj akoma, sepse më delte nga zemra, pa pasur nevojë fare për përgatitje. E, me që ishte data 21 mars, shqiptova fjalët: “Dimri po shkon! Sot fillon pranvera!”.

E, Kardinali Koliqi vijon të jetë për popullin shqiptar edhe pas vdekjes një jetë kushtuar Zotit e popullit, në një kohë kur ky përkushtim paguhej me jetë. Një jetë e jetuar për Zotin e besimtarët, për fe e atdhe, për Ungjill e kulturë.

E vërtetë nuk është e thjeshtë të përmbledhësh me pak fjalë jetën e kardinalit Koliqi, një nga figurat më poliedrike në historinë e Shqipërisë.

Mikel Koliqi lindi në Shkodër më 29 shtator 1902. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, për t'i vijuar studimet në Milano të Italisë, ku edhe u diplomua në degën e inxhinierisë mekanike, në Politeknikumin e Milanos.

Ishte në moshë të pjekur, kur ndjeu thirrjen për rrugën meshtarake, thirrje që e kurorëzoi duke u shuguruar meshtar më 30 maj 1931.

U kthye menjëherë në Atdhë dhe nisi shërbimin, më parë si ndihmës-famullitar, e pastaj si famullitar i katedrales së Shkodrës.

U shqua edhe për veprimtarinë e tij muzikore e publicistike. Muzikoi melodramat e para në historinë e muzikës shqiptare, në bashkëpunim të ngushtë me Dom Ndré Zadejën. Që kryeredaktor i revistës "Kumbona e së Dieles".

Gjatë regjimit komunist u burgos tri herë dhe u dënua me 37 vjet heqje lirie.

Papa Shën Gjon Pali II e emëroi prelat nderi (monsinjur) në janar 1992, e takoi personalisht gjatë vizitës së tij në Shkodër, më 25 prill 1993 dhe e krijoi kardinal më 26 nëntor 1994 në Vatikan.

Menjëherë pas fillimit të proceseve demokratike të Shqipërisë, kardinali Mikel Koliqi u nderua së pari me titullin "Pishtari demokracisë", më pas me titullin "Nënë Tereza" dhe, vetëm pak ditë para vdekjes,

me titullin më të lartë "Nderi i Kombit". Vdiq në Shkodër, më 28 janar 1997.

U përpoqa të përmbledh në pak rreshta të një jetë të veçantë siç që ajo e dom Mikel Koliqit, që shtrihet në gjithë hapësirën e shekullit të kaluar, një jetë e jashtëzakonshme për Fé e Atdhë që mbeti hallkë e pashkëputur nga tmerri i persekutimit ateist të komunizmit.

E jeta dhe veprimtaria e kardinalit Mikel Koliqi që e është për të gjithë shqiptarët shembull e testament shpirtëror e kombëtar, pra mbetet një udhërrëfyes për të gjithë Ne, se si duhet punuar të bashkuar e në mirëkuptim për një të ardhme më të mirë për popullin e vendin, me një përkushtim e përvujtëri, duke kërkuar e përvetësuar gjithmonë vlerat e vërteta e të shëndosha, njerëzore, shoqërore e shpirtërore e, kulturore e kombëtare.

*Imzot Angelo Massafra
Arqipeshkëv Metropolit Shkodër-Pult*





PËR TË NDËRTUAR SHPRESËN PËR NJË TË ARDHME MË TË MIRË!

*Fjala e mons. Mons. Angelo Massafra
në aktivitetin për shkollat katolike
Tiranë, me 17 maj, 2024*

Të nderuar, përshëndetje!

Historia e teksteve mësimore në gjuhën shqipe është e lidhur me atë të vetë pranisë së kishës në trojet tona. Kjo pasi shkollat e para, qysh në mesjetën e hershme, mendohet të kenë qenë krijuar pranë famullive, për t'i dhënë më së paku mundësi besimtarëve që të mësonin shkrim e këndim. Dhe për arritjen e këtij synimi, famullitarët përgatisnin dorëshkrime doracakësh të vegjël dhe ua ofronin atyre që donin të nxinin diçka. Përgjatë shekujve të mesjetës, fjalorët dhe gramatikat për nxënien e shqipes, materiale që sot mund t'i quajmë edhe tekste shkollore, i përkasin misionarëve katolikë nëpër Shqipëri, herë të mbetura pabotuar, si rasti i fjalorit të atë Luca da Montegiove e herë të tjera, të botuara nga Propaganda Fide.

Vite më vonë, në kapërcyellin mes shekujve XIX dhe XX, shtypshkronjat e ngritura pranë shkollave katolike, si për shembull ajo e së Papërlqyemes ndërtuar nga Jezuitët, ajo franceskane apo t tjera si ajo e dom Ndoc Nikajt luajtën një rol të veçantë në ofrimin e teksteve mësimore për shkollat shqipe. Në bibliografitë e librit shqip, shohim se tekste të pafundme nga të gjitha disiplinat, por kryesisht gjuhësie dhe letërsie u shtypën aty, sipas modeleve më të mira evropiane, ku meshtarët, profesorë dhe autorë të teksteve, kishin studiuar. Ato tekste, në duart e nxënësve, qenë mjeti me të cilin ndërtuan shpresën për një të ardhme më të mirë, dhe për hir të së vërtetës, gjasat janë se do ta realizonin, po të mos vinte komunizmi.

Gjatë asaj periudhe, ideologjia që mbushi tekstet shkollore jo vetëm shmangu, por nëpërkëmbi traditën para-ardhëse dhe rikrijoi, në dukje, gjithçka nga e para. Kjo ama nuk është tërësisht e vërtetë. Dyshime, më vonë të vërtetuara, se komunizmi përdori dorëshkrime tekstesh shkollore të përgatitura nga meshtarët katolikë tregojnë një kompleksim nga autori, por jo refuzim të vetë tekstit.

Kisha përherë ka shërbyer si një dritare nëpërmjet së cilës kalonte drita e së vërtetës dhe lirisë. Në frymën e kësaj qasjeje, ajo ka ofruar dhe vijon të ofrojë veten në mbështetje të të tjerëve.

Gjithë historiku i shkurtër, përmendur në pak fjalë pak më lart, tregon këtë, aq më tepër në kushte kur tejçimi i lirisë ishte një akt rezistence, i rrezikshëm dhe i dënueshëm prej pushtimeve të kohës. Kontributi i kishës jo vetëm ka qenë i pamohueshëm, por edhe i pazëvendësueshëm në krijimin e klimës më të favorshme për realizimin e qëllimit universal të sistemeve edukuese: Formimin e njeriut. Thënë gjithë kjo, Kisha jo vetëm duhet dëgjuar, por duhet ftuar në tryeza ku diskutohen tematika të kësaj natyre.

Për ta paraqitur sa më të plotë historinë shumëzërëse të Shqipërisë në tekstet shkollore, duhen specialistë, patjetër, po burimet e informacionit që atyre u ofrohen duhet të jenë të shumëllojshme. Sidomos për historinë e vonë, plagë akoma e pashuar për kombin! Zërat e viktimave s'kanë pse të jenë anësore, por qendrore. Kështu historia nuk shkruhet vetëm nga fituesit e cdo beteje, por edhe falë përjetimeve të atyre që ja kanë dalë të fitojnë betejën më të madhe: atë me të pashpresën. Në jetët e tyre, mes të cilëve janë edhe martirët tanë, triumfi i fesë, shpresës dhe dashurisë e tregon vetveten më së miri. Domsodoshmëria e këtij triumfi, ama, kuptohet vetëm me qëndresën e tyre deri sa e arritën.

Prandaj shkrimi i teksteve shkollore në Shqipëri duhet të rikthehet aty ku ka zënë fill dhe në të ta kërkojë e ta gjejë metodën për të qenë sot i të njëjtit nivel me gjithë Evropën.

Faleminderit!





RELIKA E GJAKUT TË SHËN FRANÇESKUT NGA VARRËT JETA E RE

Shkodër, 17-20. 06. 2024



Në vitin e 800 Vjetorit të Varrëve të Shenjta të Shën Françeskut të Asizit (1224-2024), Arqidioqeza Shkodër-Pult mirëpriti Reliken e gjakut të Shën Françeskut, të cilin, Jezu Krishti i Kryqëzuar e vulosi me Plagët e tij të Shenjta mbi Malin e Vernës, Itali.

Bijat e Varfëra të Varrëve të Shentja të Shën Françeskut (Motrat Stigmatine), të cilat i përkasin Përshpirtërisë së Françeskut të stigmatizuar, me miratimin e Kuries Gjenerale të Fretërve Minor si dhe në bashkëpunim me Urdhërin Françeskanë, në Shkodër, bënë të mundur ardhjen e Relikes në mesin tonë.

Ajo u shoqërua në Shqipëri nga Fr Sandro Guarguaglini OFM, Eprorja Gjenerale e Institutit të Motrave Stigmatine, Sr Encarna Lobato, zv. gjeneralja M. Dukata Radoja dhe këshilltarja sr Madaleine.

Relikja fillimisht u mirëpriti në Katedrale - "Kisha e Shën Shjefnit", nga Shkëlqësia e Tij, Arqipeshkvi Metropolitan i Dioqezës Shkodër - Pult, Imzot Angelo Massafra OFM. dhe famullitari dom Vlash Palaj, nga ku filloi procesioni drejt kishës së Motrave Stigmatine, Gjuhadol, për të vazhduar pastaj me celebrimin e Meshës së shenjte.

Të pranishëm ishin Meshtarë, besimtarë dhe rregulltare të Kongregatave të ndryshme, të cilëve fr Sandro Guarguaglini ju drejtua në homelin e tij: Të flasësh sot për varrët, për plagët e gjakosura mund të duket paradoksale, duke e parë se të gjithë kërkojnë

për të qenë absolutisht mirë dhe mjerë nëse na rrjedh gjak në ndoj gjë qoftë brenda nesh qoftë jashtë nesh.

Për Françeskun nuk ka qenë kështu. Ai ka dashur të jetë i gjakosur së bashku me Zotin e tij Jezusin. Ka dashur të rrjedhin gjak, pikërisht për të provuar në trupin e tij dhe në shpirtin e tij pak nga dhimbja e tij e pak nga dashuria e tij. Ky është mundimi i vërtetë i të dashuruarve, të marrin pjesë plotësisht në dashuri të të dashurit; kjo është ajo që na tregon Shën Bonaventura për pervojën e Atit Serafik.

Konteksti i stigmave, është shumë i habitshëm sepse nuk është një kërkesë normale, kërkohet për të vuajtur dhe për të gëzuar, përkundrazi kërkohet për të galduar duke vuajtur si Jezusi. Nuk mundemi në këtë kontekst ta shkëpusim dashurinë nga dhimbja sepse do të largohemi përkundrazi do të shkëputemi nga çfarë Françesku ka dashur të jetojë, ne dijmë vetëm, që Jezusi, këtu në këtë mal, ia plotësoi dëshirën shën Françeskut. Përballë hirit sublim, do të tregonim me biografët e Sh. Françeskut, për dashurinë e zjarrtë të serafikut, ne mund të ulemi vetëm në gjuhë për të adhuruar misterin e kryqit, sespe për kryqin bëhet fjalë. Plagët janë maja e një ecje, vula na thotë Sh. Bonaventura, janë kulmi i një ecjeje shpirtërore dhe ungjillore; Françesku është 'alter Cristi' dhe Sh. Kjara e dëshmon me fjalë të forta, fjalë e të cilës ka bashkëndarë të njëjtën jetë, fjalë që nuk janë poezi, por janë dëshmi të gjalla: i lumi atë ynë Françesk i dashuruari dhe imituesi i Krishtit. Nuk jemi përballë



një koncepti, një tregimi, jemi brenda një përvojë, brenda një jete, dhe për këtë jetë Françesku do që ta jetojë: Mundimin, vdekjen dhe Ringjalljen e Zotit tonë Jezu Krishtit. Për këtë Françesku guxon të kërkojë, tashmë jeta e tij ka njohur të gjithë jetën e Jezusit, tani dëshiron ta provojë në mishin e tij të gjallë; dëshiron ti ndiejë gozhdat të ngulura brenda tij, dëshiron për të provuar dhimbjen që provokon dashurinë, pikërisht si Jezusi, që ndërsa po vuante tmerrsisht e dhuroi jetën për ne.

Plagët janë përgjigjia e Jezusit ndaj një pyetje që kishte filluar në rini: O Zot, çfarë dëshiron që të bëj. E Jezusi i përgjigjet: të kam dhënë plagët që ti të jesh stema ime. Ja çfarë do Jezusi prej tij, që të jetë paraqitja e tij, ikona e tij. Françesku gjendet i plagosur në trup, jo vetëm në shpirt, por i gjithë personi i tij është i mbështjell nga ky mister i dashurisë dhe i dhimbjes, nuk ka më asgjë në të që nuk i përket Jezusit. Plagët bëhen njohja intime e Kryqit, ai Kryq që i kishte folur në kishën e Sh. Damianit; jam njohja intime e atij Fëmije që kishte mbartur në krahët e tij në Greço; jam njohja e Eukaristisë e marrur shumë herë, jam njohja intime i të gjitha takimeve me Jezusin mbi Malin e Vernës dhe që tani jam e vërteta e sigurt.

Afër festës së Lartësisimit të Kryqit (14 shtator), meditimi mbi të Kryqëzuarin, kishte ngritur zërin me pyetjet e tij: “Dy hire të këprkoj që të më dhurosh ... “Të hyjë në dhimbjen më të cilën ti, o Zoti im, më ke dashur ... Të kem pak nga dashuria e jote aq sa është e mundur të duroj dhimbjen tënde!” Dhe Miku erdhi, një natë, nga Lindja, i shëndritshëm, i gëzuar dhe i plagosur e përqafoi, duke e shënjuar me të njëjta

plagë. Varrët u bënë “vula” që gjymtyrët e tij i mbartën për dy vite. Është dhuratë-thesarë i muajit shtator 1224, dashuria që vulos dashurinë e të dashurit. Françesku, ruajtës i ndrojtur i kësaj dhurate, është flamuri i Krishtit të varfër dhe të kryqëzuar. Aventura njerëzore e ndjekjes 20 vjeçare pas Krishtit kishte arritur kulmin; dashuria e plagosur që ishte e vulosur në zemër përpara të Kryqëzuarit bizantin në kishat përreth Asizit, lulëzoi atje lartë, mbi shkëmbijt e thepisur, në katedralen e madhe të botës ... pesë plagë të shndritshme dashurie që ia konsumuan dal nga dalë atë pak shëndet që i kishte mbetur.

Letra e Galatasve 6, 14-18 që sapo kemi dëgjuar na kujton përvojën e Stigmave që edhe Sh. Pali i ka pasur: “unë mbart në trupin tim shenjat e Jezusit”. Është ftesë për të hyrë edhe në brenda të njëjtit mister të dashurisë dhe të dhimbjes dhe të bëhemi pjesmarrës së vdekjes dhe të ringjalljes.

Si mundemi ne sot ta jetojmë këtë? Si mund të jemi të stigmatizuar, të plagosur nga dashuria e Jezusit? Është i njëjti atë serafik që na mëson duke na ftuar që të pranojmë në ne gjithçka është e Jezusit dhe t’ia rijapim atij gjithçka që na ka dhënë. Të lejojmë që të tërhiqemi nga kjo dashuri është e rrezikshme sepse na merr krejtësisht, edhe se nuk i kemi plagët, por duhet që edhe ne të jemi të gatshëm për të hyrë në bashkim intim me të, përmes përvojës së përditshme me Fjalën e Tij dhe me gjakun e trupin të tij.

Për ne sot bëhet urgjente, në këtë kohë ku gjaku rrjedh kotësisht, të jemi mbartës e një dëshmie të një njeriu që ka qenë plagosur për dashuri, një dashuri që edhe pse plagos shpëton dhe jep jetë. Edhe ne, duhet të besojmë, si Françesku që ato Plagë na kanë shëruar.





Sa vëllezër dhe motra, në shtratin e dhimbjes, janë të shënjuar nga vuajtja, qoftë fizike, shpirtërore ose psikologjikisht janë të bashkëngjitur Varrëve të Jezusit dhe me Të marrin pjesë në nganjimin e Tij Pashkvnor, sepse Krishti Jezus është ngadhnyes, sepse vuajtja edhe pse në dukje është një humbje, nëse e bashkuar me atë të Zotit është një shenjë ngadhënjimi. Jemi përsëri në paradoksin ungjillor, por ne jemi të krishterë brenda historisë së shëlbimit. Pranimi, edhe pse e vështirë dhe ofrimi i vuajtjeve tona janë shkak i shpëtimit për botën, përkundrazi janë lutja më e bukur. Duhet të mësojmë nga Sh. Françesku si të raportohemi me vuajtjen, me dhimbjen, me vdekjen, pikërisht sepse sot ka nevojë për këtë dëshmi, që është më e vërteta, sepse ai që vuan nuk flet por jeton. Atëherë kush vuan, ne, kemi në kishë një vend të privilegjuar, jemi në zemër të ngrohtë të Sh. Françeskut, në atë zemër që ndërmjetëson vazhdimisht pranë Zembrës së Jezusit. Për të rinjtë, që shpesh e kanë humbur kuptimin e jetës dhe janë në kërkim të rrugëve që sjellin vetëm drejtë vdekjes, për familjet, të tunduara nga valët djallëzore të sulmeve të ndryshme, që të dijnë të qëndrojnë të bashkuara. Për burrat dhe gratë, mbi të gjithë për të krishterët e përsekutuar, të përqeshur dhe të sulmuar, që qëndresa e tyre dhe sakrifica qofshin

farë e paqes dhe e shpresë së jetës së re. Për të gjithë ne, që në ecjen e jetës sonë të dijmë të pranojmë vuajtjen dhe ta jetojmë si një akt i dashurisë më të madhe drejtë Hyjit. Për ju të dashura Motra Stigmatine, që mbani emrin bija, dëshironi më të vërtetë të bëni përvojën e kësaj dashurie dhe të vuajtjes shpëtimprurëse, duke u kujdesuar njëra ndaj tjetrës, për plagët, për gëzimet, të ecjës së vëllezërve e motrave që të bëheni edhe ju, ikona të të Kryqëzuarit të ngjallur.

Rilika vazhdoi pelegrinazhin e saj në kishat françeskane në qytet: Monastiri – “Shën Kjara”, në të cilën u celebrua Meshja e Shenjtë nga Fr Aurel Gjerkaç, zv Kustodi i Fretërve Minor. Vijoi kështu në Kishën – “Shën Maria Magdalenë”, pranë Fretërve Kapuçin në Tarabosh – i cili celebroi Meshën e Shenjtë, Arqipeshkvi Imzot Angelo Massafra, duke u mbyllur kështu me kremtimin e Meshës Solemne e udhëhequr nga Nunci Apostolik Sh. e Tij, Imzot Luigi Bonazzi, në Kishën e Shën Françeskut, Gjuhadol.

Qoftë bekim e hir për Familjen Françeskane ndër shqiptare dhe për mbarë popullin tonë.

Motrat Stigmatine



MËSHIRËS SATE O ZOTI IM, NË AMSHIM DO T'I KËNDOJ

*Shtegtim i Famullisë së Dajçit, Bregu i Bunës, dt. 5. 06. 2024,
në Katedralen e Shkodrës për Ndjesën e Plotë!*

Kisha katolike në Shqipëri po përjeton një kohë hiri dhe bekimi si fryt i gjakut të Martirëve të saj që tashmë i përkasin mbarë Kishës Universale. Rasti i Lumnimit të 38 Martirëve të Kishës në Shqipëri, me datë 05 Nëntor 2016, na kanë dhënë mundësinë që të shijojmë Mëshirën e Zotit çdo datë 5 të çdo muaji. Kjo falë provanisë së Zotit dhe bujarisë që Papa Françesku u ka dhënë besimtarëve katolik Shqiptar, që të marrin *Ndjesën e plotë*, pra faljen e mëkateve, duke shtegtuar në Kishën Katedrale, duke u rrëfyer e duke marr pjesë në Meshën Shenjte.

Me këtë rast edhe famullia jonë e Dajçit, shtegtoi e organizuar me datë 5 qershor 2024, në Katedralen e Shkodrës, ku besimtarët patën mundësinë të rrëfeshen e të marrin pjesë në meshën shenjtë po në atë Kishës, duke marrë edhe Ndjesën e Plotë, si shenjë e mëshirës së pakufi të Zotit. Ishin të pranishëm gati të gjitha shtresa: fëmijë, të rinjtë, pleq e plaka. I gjithë populli i Zotit është në shtegtim drejt mbretërisë së Zotit. Prandaj edhe shtegtimet këtu në tokë na kujtojnë se



jemi në ecje me Zotin dhe drejt bashkimit të plotë me Të.

Pas çdo hiri që jepet në Sakramentin e Pajtitimit, rilind gëzimi në zemër. Kjo ishte edhe ndjesia e veçantë që provuan besimtarët në këtë ditë mëshire, falje dhe pajtimi. Çdo takim me Zotin e sidomos ai i faljes është takim mëshire, falje dhe burim gëzimi. Ky është edhe shkaku i gëzimit tonë. Në thotë Papa Françesku: "*Sakramenti i Pajtitimit është moment*

feste, sepse Zoti na ri-jep jetën, na përqafton dhe nga ri-ngritë në këmbë e madje edhe na nis në mision, që t'ua shpallim edhe të tjerëve gëzimin e faljes dhe të pajtitimit".

Falënderojmë Zotin për Mëshirën e tij të pakufi, se vetëm falje dhe mëshira bëhet energjia jonë shpirtërore për të vazhduar shtegtimin tonë drejt takimit përfundimtarë me Të. I krishteri ecën dhe lëvdon Zotin sepse thellë në zemrën e vet ka sigurinë se nuk është kurrë vetëm, se pranë tij është Ai që e do, që e fal nëse gabon dhe, që i jep zemër kur lodhet nga vështirësitë e jetës.

Kronisti





P. CAMILLO LIBARDI, NJË PËRMBLEDHJE ME DOKUMENTE PËR HISTORINË E SHQIPËRISË

Misionari që jetoi 45 vjet radhazi në Shqipëri. Si u zbulua dorëshkrimi “Sylva documentorum et Albaniam pertinentium. I-III”, frut i një pune të madhe e të lodhshme në arkivat dhe bibliotekat e ndryshme italiane, dorëshkrimin e së cilës P. Libardi e nisi për botim në Romë gjatë kohës së pushtimit fashist italian...

Shqipëria, veçanërisht pjesa veriore e vendit ka qenë vijimësisht një tokë misionare dhe posaçërisht këtë veprimtari e kanë mbajtur gjallë prej 8 shekujsh françeskanët, kryesisht ata italianë. Pikërisht për këtë fakt, një histori misioneve françeskanë këndej Adriatikut do të kishte qene tejet interesante në shumë apekte, qoftë historike, sociale, fetare dhe kulturore

Një ndër misionarët që jetoi për 45 vjet radhazi në Shqipëri ishte P. Camillo Libardi nga Trento. P. Camillo lindi më 7 dhjetor të vitit 1863. Veshi petkun françeskan më 5 mars 1880 dhe u shugurua meshtar më 2 janar të vitit 1887. Më 5 prill 1888 u paraqit në Romë nën thirrjen e Propagandës Fide, e cila e dërgoi misionar në Shqipëri. Shërbeu në Pult për 45 vjet me radhë deri në vitin 1937.

Kjo ka qene për të e për shumë kënd si ai, periudha e vështirë misionare mes maleve përmes të cilave atij i duheshin orë të tëra për të mbërritur familjet të cilat jetonin pothuajse në një gjendje primitive të shpërndara anë e kënd grykave të humbura mes izolimit total prej qytetërimit nën persekutimin e ashpër osman.

Personaliteti i tij i fortë, inteligjenca e spikatur dhe mbi të gjitha energjia dhe vullneti i tij i jashtëzakonshëm për t'iu gjendur pranë besimtarëve të grigjës që i ishte besuar, qe mbi të gjitha vlera e jashtëzakonshme e karizmës françeskanë që përcolli frati françeskan përmes zhgunit të murrme lidhur me konop të bardhë dhe sandaleve pa çorape. Libardi do të vërë re se natyra e egër e shqiptarit të këtyre anëve ishte bërë e tillë jo prej karakterit të tyre, por prej mungesës së qeverimit. Shala, Shoshi, Thethi e Nikaj ishin zhytur në gjakmarrje.

Vetëm në vitin e parë të apostullimit të P. Libardit pati 43 vrasje. Për këtë arsye ai mori nismën për të mbledhur e bërë bashkë krerët e fiseve për 3 ditë radhazi dhe me 5 qershor u 1890 u arrit një marrëveshje mes tyre që të kishte besë mes sosh dhe sidomos për të mbajtur të sigurtë rugëkalimin mes këtyre zonave që shkonte për në Fushë Kosovë, besë që mbeti në fuqi deri në vitin 1894.

Shpërthimi i kryengritjes në Veri të vendit gjatë vitit 1911 dhe sidomos ofensiva e Shefqet Turgut Pashës mbi Mirditë e Dukagjin dhe sjellja e dyfishtë e Kral Nikollës, bëri që me nismën e P. Libardit më 17 korrik 1911 të arrihej një marrëveshje tjetër mes krerëve të dy besimve në kështjellën e Drishtit, marrëveshje e cila iu konfirmua edhe Valiut të Shkodrës.

Shfaqja e një personaliteti të tillë do të ishte edhe një arsye fortë që ai të propozohej edhe si një ndër 3 kandidatët e mundshëm për ipeshkëv të Pultit, detyrë të cilën ai e refuzoi për shkak të moshës së tij të re. Në vitin 1907 Shenjtëria e tij Papa Piu X e dekoroi me medaljen e mirënjohjes për veprën e tij misionare. Me Shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë më 1912 ai qe zgjedhur drejtor i Kryqit të Kuq Shqiptar në nënprekefturën e Dukagjinit ku pat hapur në vitin 1926 edhe një qendër ambulante misionare në famullinë e Shosit.

Pas kryengritjes së Dukagjinit dhe përgjakjes që i bëri Ahmet Zogu kësaj krahine, si rezultat i hakmarrjes së ashpër monarkike me këshillimin e Propagandës Fide, P. Libardi në vitin 1932 e lëshon plot pas 45 vjetësh misionin e tij aq shumë të dashur në Shqipëri.

P. Libardi përjetoi konkretisht ngjarjet e rëndësishme që rrodhën në Shqipëri në kapërcyll të dy shekujve duke ndjekur me kujdes e vëmendje si dhe duke mbështetur me të gjitha format dhe mënyrat patriotët shqiptarë gjatë dhe pas Shpalljes së Pavarësisë, dëshmia më e mirë e së cilës do të dilte si produkt i kësaj veprimtarie libri i tij voluminuz në dy pjesë I primi moti patriottici albanesi nel 1910 - 1911 - 1912: specie nei Dukagini (1935), i cili për habi të madhe ende nuk ka tërhequr vëmendjen e ndonjë botuesi shqiptar për t'iu përkthyer në gjuhën shqipe. Libardi njohu nga afër Luigj Gurakuqin, At Gjergj Fishtën, Ernest Koliqin, Bajram Currin, Muharrem Bajraktari, Gjon Markagjoni, Dom Lazër Shantojën, Rexhep Shalën, Imzot Luigj Bumçin, At Bernardin Shllakun, Imzot Lazër Mjedën, Musa Jukë, Gjon Gazullin etj. Në vitet e fundit të jetës qe emëruar “Cavalliere della Corona d'Italia” si dhe anëtar i Comisionit Adriatik për Studimet Shqiptare (Commisssione Adriatica per gli Studi Albanesi). Më 22 dhjetor 1942 u shtrua në infermieri në Trento ku edhe ndërroi jetë më 26 febraio 1943.

P. Camillo Libardi botoi tre vepra: I primi moti patriottici albanesi nel 1910-1911-1912: specie nei Dukagini. (1935); Il missionario Albanese sul campo di battaglia, ovvero ricordi della vita di p. Alberto Craçhi O. M. vescovo di Pulati in Albania. (1935); Come si è fatto re d'Albania Ahmet Zogu (1940); Si u bë mbret u Shqipërisë Ahmet Zogu. Tiranë, 2012.

Pikërisht në kohën e pushtimit italian studiuesi italo-dalmat Giuseppe Praga kishte ideuar projektin e botimit të “Monumenta Albaniae Historica”, pjesë e së cilës do të ishte vepra e tij (Libardit) e lënë dorëshkrim Sylva documentorum et Albaniam pertinentium.

I-III, frut i një punë të madhe e të lodhshme e plot durim në arkivat dhe bibliotekat e ndryshme italiane, dorëshkrimin e së cilës P. Libardi e nisi për botim në Romë. Në vitin 1942, në një artikull të botuar në Rivista d'Albania studiuesja italiane Ferdinanda Granata thekson se për misionet italiane në Shqipëri në gjysmën e parë të shekullit të XVII, është bazuar në pjesën më të madhe mbi burimet e mbledhura nga P. Libardi në veprën e sipërpërmendur, sipas saj të përmbledhura në 3 vëllime, 2 prej të cilave ajo i citon përgjatë studimit. Periudha e luftës solli peripeci të shumta që dihet që u pasuan me ato të pasluftës dhe dorëshkrimi i p. Camillo-s humbi gjurmët. Kërkimeve tona të shumta të bëra në Shqipëri; në Arkivin Qendror të Shtetit, Arkivin e Institutit të Historisë, Bibliotekën Kombëtare në Tiranë, Bibliotekën “Marin Barleti” në Shkodër dhe bliotekën Françeskane po në Shkodër nuk dhanë rezultat.

Redaksia

AMARCORD

“Shqiptarët besonin tek Meshtari i Mrekullive”

Çdo javë që i paraprin 13 Qershorit, mbi lartësitë kodrinore përreth Laçit, sheh mijëra besimtarë të bashkohen në Kishën e Shna Ndout. Kisha e Laçit mban emrin e meshtarit françeskan Shën Antonit të lindur në Lisbonë në vitin 1195.

Mësuesi shenjtor Shna Antoni i Padovës (siç njihet në literaturën kishtare) njihet për dijet e thella, aq sa Papa Gregori IX e quajti “Arka e gjallë e Biblës”.

Kisha e Laçit u ndërtua nga françeskanët në vitin e largët të 1300-ës. Kompleksi i hershëm i shpallur në vitin 1966, *Zonë Ushtarake*, u shkatërrua plotësisht nga sistemi komunist, në vitin 1971.

Në kodrën shkëmbore sipër qytetit, ende imponohet kompleksi me të përpjeta në shkallë. Shqiptarët besonin tek Meshtari i Mrekullive dhe çdo vit ngjisinin kodrën fshehurazi edhe kur besimi ishte i ndaluar për të kërkuar ndihmën e tij. Sot, i gjithë procesioni i ngjitet së njerëzve, nëpër shkallë gurësh, shkrepë e shkëmbinjsh, të zbatshur, të sëmbuarit të mbajtur për krahësh o në vig, të rij, djem, vajza e gra të reja, të organizuar krejtësisht në mënyrë private, në Kishën e Laçit të rindërtuar pas '91 është mbresëlënëse.

Pasi viziton Kishën, shumë zbresin në “Shpellën e Shën Vlashit Martir” por ka të tjerë pelegrinë që i luten shenjtit kur ndalojnë tek vendi i qirinjve. Kisha përfaqëson, në historinë e para viteve '91, një nga hapësirat më të martirizuara sepse aty mijëra lutje të dala nga zemra ju drejtuan meshtarit për ndihmë.



Manastiri fotografuar nga kodra ku ruhen muret e fortifikimit antiko-mesjetar të Sebastës, Monument Kulture , Kategoria I. Marubi, fillim shek. XX






VITRINË LIBRI

Luigj Junçaj

KJO TOKË JU PRET

Botimet TOENA
Tiranë 2024



Camillo Libardi

**SYLVA DOCUMENTORUM SPECTANTIUM
AD MISSIONEM PULATENSEM**

Faik Konica Albanisches Institut
Prishtinë - St. Gallen, 2023



Anila Omari

**STUDIME RRETH SHQIPES
SË VJETËR**

Tiranë, 2022

KUMBONA E SË DIELËS

revistë fetaro-kulturore dymujore
e Kryedioqezës Metropolitane Shkodër-Pult

Tirazhi: 100 kopje

Çmimi: 100 lekë (Evropë: 2 Euro)

Parapagimi vjetor 600 lekë

(Evropë: 12 Euro)

e-mail: n_ukgjini@yahoo.it

Web page: www.kishakatolikeskoder.com

Adresa: Arqipeshkvia Shkodër,

Sheshi "Gjon Pali II"

Shtypur në eleven studio - www.11stud.io

KUMBONA E SË DIELËS

Viti XXXVII, nr. 5/6 (579-580) Maj - Qershor 2024